

MANUAL

PËR APLIKIMIN E QASJES SË BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT

Informacione dhe udhëzime për integrimin
e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut në punën
e organizatave të shoqërisë civile në RM

MANUAL

PËR APLIKIMIN E QASJES SË BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT

Informacione dhe udhëzime për integrimin e qasjes së bazuar
në të drejtat e njeriut në punën e organizatave të shoqërisë civile në RM

Manual për aplikimin e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut -

Informacione dhe udhëzime për integrimin e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut në punën e organizatave të shoqërisë civile në RM

- Botues:
 - **Instituti për të Drejtat e Njeriut i RM**
- Autorë:
 - **Goce Kocovski, Maja Atanasova**, Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj – Kapitulli 1 dhe 5
 - **Natali Petrovska, Darko Avramovski**, Koalicioni Të gjithë për Gjykim të Drejtë – Kapitulli 2
 - **Ena Bendevska**, Komiteti i Helsinkit për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut i RM – Kapitulli 3
 - **Maja Stojanoska**, Instituti për të Drejtat e Njeriut – Kapitulli 4
- Redaktor:
 - **Miroslav Draganov**
- Përkthim:
 - **Edita Jasari**
- Korrektura:
 - **Tatjana Stojanoska**
- Modelimi vizatimoro-grafik:
 - **Relativ**

Mirënjohje: Autorët janë mirënjohës për këshillat dhe redaktimin e ofruar nga ekipi i Civica Mobilitas, Simon Forester dhe Petrus Theunisz



- Ky dokument u mundësua me mbështetjen e Programit Civica Mobilitas. Civica Mobilitas është Projekt i Agjencisë Zvicërene për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), të cilin po e zbatojnë NIRAS nga Danimarka, Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (MCMS) dhe Instituti Suedez për Administratë Publike (SIPU).
- Përbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit për të Drejtat e Njeriut, Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj, Koalicionit Të gjithë për Gjykim të Drejtë, Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pikëpamjet e Civica Mobilitas, të Agjencisë Zvicërene për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), ose të organizatave që po e zbatojnë atë.

Përmbajtja:

Përmbledhja ekzekutive	5
Vërejtjet hyrëse	8
Kapitulli 1: Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut – Përkufizimi dhe domethënia?.....	11
Përkufizimi i qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut.....	12
QBDNJ përkundër të gjitha qasjeve tjera në programet zhvillimore.....	13
Poseduesit e të drejtave dhe bartësit e detyrave.....	14
Përfitimet nga aplikimi i QBDNJ.....	15
Kapitulli 2: Parimet bazë të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut.....	16
Universaliteti dhe patjetërsueshmëria.....	17
Pandashmëria.....	18
Pjesëmarrja.....	18
Barazia.....	18
Llogaridhënia/përgjegjësia.....	19
Kapitulli 3: Liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit të njohura me të drejtën ndërkombëtare.....	20
Konceptet themelore të dinjitetit të njeriut.....	21
Përshkrimi i liritë dhe i të drejtave themelore të njohura me të drejtën ndërkombëtare.....	22
Marrëveshjet (dokumentet) ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.....	23
Detyrimet e shteteve.....	27
Mbikëqyrja e përmbushjes së obligimeve të shteteve që dalin nga instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.....	27
Kapitulli 4: Grupet e cenueshme dhe të marginalizuara në Republikën e Maqedonisë.....	28
Personat që jetojnë në varfëri të skajshme.....	29
Pjesëtarët e komunitetit etnik rom.....	30
Fëmijët.....	31
Gratë.....	31
Personat me aftësi të kufizuara.....	32
Popullsia LGBTI.....	32
Personat e moshuar.....	33
Kapitulli 5: Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut dhe cikli i projektit.....	34
Hapi 1: Analiza e gjendjes.....	37
Hapi 2: Planifikimi dhe disenjimi i projektit.....	41
Hapi 3: Zbatimi.....	42
Hapi 4: Monitorimi dhe vlerësimi.....	43
Lista e kontrollit – A aplikon projekti i caktuar qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut?	44
Bibliografia	46

Përmbledhja ekzekutive



Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut është relevante për të gjitha organizatat e shoqërisë civile

Realizimi i mbrojtjes së dinjitetit njerëzor i të gjithë qenieve njerëzore qëndron në thelbin e konceptit të të drejtave të njeriut, duke vënë individin në qendrën e vëmendjes. Kuptimi i parimeve dhe procedurave të të drejtave të njeriut ua mundëson njerëzve të marrin pjesë në vendimet shoqërore, të cilat ndikojnë në jetët e tyre për të vepruar në drejtim të zgjidhjes së konflikteve, përmirësimit të standardeve jetësore dhe mundësimit të një ambienti të prosperitetit.

Komunitetet, qeveritë dhe bashkësia ndërkombëtare duhet të përballen me sfidën për luftimin e parimeve bazë të shkeljes së të drejtave të njeriut, që çojnë drejt diskriminimit, marginalizimit, përjashtimit social dhe qasjes dhe shpërndarjes jo të drejtë të përfitimeve nga mallrat dhe shërbimet publike. Këtu, qasja e bazuar në të drejtat e njeriut në kuptimin e zhvillimit, po bëhet relevante.

Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut (QBDNJ) paraqet një kuadër metodologjik, i cili ka për qëllim t'i integrojë të drejtat e njeriut në çdo program zhvillimor, si dhe në sigurimin e projekteve dhe shërbimeve. Si koncept, QBDNJ siguron një përfshirje të konsiderueshme dhe sistematike, si dhe fuqizimin e personave më të cenueshmë.

Për arsye të pranimit dhe aplikimit të vazhdueshëm e gjithnjë në rritje të këtij parimi dhe për fuqizimin e dëshmuar që bartë me vete, është me rëndësi që shoqëria civile, organet shtetëtare dhe sektori i biznesit të njihen me bazat e aplikimit të QBDNJ. **Integrimi sistematik i kësaj qasjeje në punën e përditshme të organizatave të shoqërisë civile do ta përmirësojë respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në vend.**

QBDNJ u shërben gjithë qytetarëve, e sidomos atyre që janë të marginalizuar dhe të përjashtuar nga shoqëria, sepse të drejtat e tyre më së shpeshti ose mohohen, ose mbeten të papërbushura – pavarësisht nëse i takojnë sferës sociale, ekonomike, politike ose kulturore, ose, siç është më së shpeshti rasti, kombinimi i tyre. QBDNJ nënkupton ndryshimin në fokusin dhe motivet e zbatimit të programeve dhe projekteve zhvillimore. Kështu, **fokusi transmetohet nga përmbushja e nevojave në realizimin e të drejtave. QBDNJ pranon njerëzit jo si shfrytëzues pasivë të shërbimeve, por si bartës të të drejtave, të cilët gëzojnë të drejtën që të kërkojnë realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre nga bartësit e detyrave, që janë të obliguar për sigurimin e realizimit të këtyre të drejtave.**

Me respektimin e QBDNJ, organizatat e shoqërisë civile dhe organet publike në mënyrë të plotësueshme do të çojnë drejt intervencave më mirë të analizuara dhe të fokusuara strategjike, me sigurimin e bazës normative për bërje ballë çështjeve zhvillimore fundamentale. Veç kësaj, QBDNJ do të ndihmonte të sillen kërkesat thelbësore për transformim shoqëror. Transformimi i tillë jo vetëm që kërkon ndryshimin e procesit, rezultatin dhe administrimin e zhvillimit, por gjithashtu do të çojë drejt zhvendosjes së vlerave dhe sjelles konsekuente. Ky Manual është hartuar për t'i udhëhequr organizatat e shoqërisë civile në drejtim të kontributit për ndryshimet e tilla të nevojitura.

Të kuptuarit e koncepteve bazë dhe parimeve udhëheqëse

Standardet e të drejtave të njeriut, si dhe parimet e përfshira me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, me konventat e OKB dhe me dokumente tjera ndërkombëtare për mbrojtjen dhe avancimin e të të drejtave të njeriut kanë vendosur parimet e QBDNJ. Këto **parime bazë janë: universaliteti; patjetërsueshmëria; pandashmëria; ndërvarësia dhe lidhja e ndërsjellë; pjesëmarrja e qytetarëve në marrjen e vendimeve; mosdiskriminimi dhe barazia; përgjegjësia dhe sundimi i ligjit; si dhe transparencja dhe aksesimi në informacione.** Këto parime mund të aplikohen në tërë planifikimin strategjik të organizatës dhe në tërë procesin e saj të programimit, duke përfshirë këtu vlerësimin dhe analizën, planifikimin dhe hartimin e projekteve, sigurimin e shërbimeve dhe vëzhgimin dhe vlerësimin. Në këtë mënyrë, **QBDNJ ia bën të mundur organizatës jo vetëm të ketë parime kryesuese për strategjinë e vet, por edhe mënyrën me të cilën ajo zbaton punën e vet.** Aplikimi i QBDNJ nuk duhet të vendosë një mënyrë plotësisht të re të punës. Kjo thjeshtë nënkupton një qasje të ndërgjegjshme dhe sistematike, duke u kushtuar vëmendje të drejtave të njeriut në të gjitha aspektet e punës.

Një aspekt posaçërisht i rëndësishëm i aplikimit të QBDNJ është fakti se ai ndihmon organizatat e shoqërisë civile të identifikojnë dhe të përshtatin mbështetjen e vet në ato segmente dhe grupe të shoqërisë, të cilat po përballen me përjashtim social, varfëri, diskriminim dhe marginalizim. Këto grupe të cënueshme zakonisht janë viktima të shkeljes së të drejtave dhe të politikave të padrejta, dhe si pasojë, ata kanë nevojë për mbështetje në kërkimin e shfrytëzimit të të drejtave të veta. Andaj, aftësia për ta kuptuar dhe identifikuar cënueshmërinë paraqet një kapacitet vital për organizatat e shoqërisë civile, dhe kështu, ky

Manual shqyrton sfidën për analizimin e cenueshmërisë në Maqedoni dhe si ajo lidhet me QBDNJ, me inkuadrimin e shembujve të grupeve të cenueshme specifike, siç janë: personat që jetojnë në kushte ekstreme të varfërisë, pjesëtarët e komunitetit etnik rom, fëmijët, gratë, personat me nevoja të posaçme, popullsia LGBTI dhe personat e moshuar. Këto bartës të të drejtave janë grupe të përbashkëta qëllimore të organizatave të shoqërisë në Maqedoni, dhe ky Manual tregon se si QBDNJ mund t'i përgjigjet pasivitetit të bartësve relevantë të detyrimeve.

Manual për praktikuesit

Ky Manual ka për qëllim t'i ndihmojë organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët e tyre në të kuptuarit e domethënies së termit «Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut», parimet, përmbajtja dhe mënyra e aplikimit të saj në punën e përditshme në kontekstin e Maqedonisë. Kështu, kapitujt janë renditur në një format të thjeshtë, që ta shpiejnë lexuesin nëpër të gjitha bazat e QBDNJ dhe të sigurojnë drejtimit për atë se ku mund të gjenden informacione plotësuese. Ajo që është më me rëndësi, objektivi praktik i Manualit është të ndërtohet kapaciteti në kuadër të organizatave të shoqërisë civile, në lidhje me mënyrën se si mund ta aplikojnë QBDNJ përgjatë hartimit dhe zbatimit të dokumenteve, programeve, projekteve strategjike, si dhe të aktiviteteve individuale. Manuali synon ta pozicionojë QBDNJ si gur-themel për të gjitha organizatat e shoqërisë civile në Maqedoni dhe të frymëzojë dhe t'i informojë për aranzhimet praktike të nevojitura për sigurimin e qasjes së barabartë në mallrat dhe shërbimet publike, si dhe në drejtësi.

Verejtjet hyrese



Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut

Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut, QBDNJ (*Human rights-based approach*) paraqet një kuadër metodologjik, qëllimi i të cilit është integrimi i të drejtave të njeriut në të gjitha programet zhvillimore, projektet dhe aktivitetet. Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut bën ndryshimin në fokusin dhe motivet për të cilat zbatohen programet dhe projektet zhvillimore. Nga përmbushja e nevojave, fokusi kalon në realizimin e të drejtave. Për qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut, personat nuk janë vetëm shfrytëzues pasivë të shërbimeve, por janë edhe *posedues të të drejtave*, të cilët gëzojnë të drejtën e realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre nga *bartësit e detyrave*, të cilët kanë për obligim të sigurojnë realizimin e këtyre të drejtave.

Në dekadën e fundit, kjo qasje gjithnjë e më tepër po aplikohet edhe në mesin e organizatave tjera ndërkombëtare dhe të organizatave donatore. BE në vitin 2012¹ mori përsipër obligimin në planifikimin dhe zbatimin e programeve dhe projekteve të cilat do t'i mbështesë, që të integrohen parimet e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut. Për shkak të pranueshmërisë dhe aplikimit gjithnjë e më të madh të kësaj qasjeje, hapet nevoja për familjarizimin më të madh të shoqërisë civile, të organeve shtetërore si dhe të sektorit të biznesit me parimet e saj bazë.

Qëllimet dhe përdorimi i Manualit

Ky Manual ka për qëllim t'i përgjigjet nevojës për disponueshmërinë e informacioneve mbi qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut në gjuhët që fliten në Republikën e Maqedonisë. Qëllimi i Manualit është t'i njohtë përfaqësuesit e shoqërisë civile me domethënien e termit *qasje e bazuar në të drejtat e njeriut*, parimet dhe përmbajtjen e saj dhe me mënyrën me të cilën ajo po aplikohet në punën e përditshme. Manuali do të mundësojë rritjen e aplikimit të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut gjatë hartimit dhe zbatimit të dokumenteve strategjike, programeve, projekteve dhe aktiviteteve vetjake të organizatave të shoqërisë civile.

Me integrimin sistematik të kësaj qasjeje në punën e organizatave të shoqërisë civile pritet dhe përmirësimi i respektimit dhe i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në vend.

Përveç përfaqësuesve të shoqërisë civile, ky Manual është menduar edhe për përfaqësuesit e pushtetit shtetëror dhe lokal, si dhe të sektorit të biznesit, duke patur parasysht karakterin horizontal të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Metodologjia e hartimit të Manualit

Manuali është përpiluar nga një ekipi të hulumtuesve juridikë, të cilët janë përfaqësues të: Institutit për të Drejtat e Njeriut, Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj, Koalicionit Të gjithë për Gjykim të Drejtë dhe të Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të RM. Gjatë përpilimit të Manualit, janë marrë parasysht dokumentet themelore të cilët përkufizojnë qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut, të sjella nga OKB dhe BE, si dhe një numër të lart të dokumenteve të publikuara dhe të manualeve dhe udhëzuesve të vëna në dispozicion, të cilët kanë të bëjnë me këtë çështje (Lista e plotë e literaturës së shfrytëzuar është përfshirë me Aneksin 1 të këtij Manuali). Manuali përmban informacione dhe udhëzime rreth termit dhe përmbajtjes së qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut, si dhe parimet bazë të qasjes. Manuali ofron një pasqyrë të kuadrit ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, e cila është baza e qasjes. Në fund, Manuali përmban udhëzime për integrimin e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut në punën e përditshme.

¹ EU Strategic Framework and Action Plan on Human Rights and Democracy, Council of the European Union, Luxembourg, 25 June 2012. E disponueshme në: https://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/EN/foraff/131181.pdf

Përmbajtja e Manualit:

Kapitulli 1:

Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut - përkufizimi dhe domethënia

Kapitulli 2:

Parimet bazë të qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut

Kapitulli 3:


Të drejtat e njeriut të njohura me të drejtën ndërkombëtare

Kapitulli 4:

Cenueshmëria dhe qasja e bazuar në të drejtat e njeriut

Kapitulli 5:

Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut dhe cikli i projektit



Kapitulli 1:

Qasja e bazuar në të
drejtat e njeriut –
Përkufizimi dhe
domethënia?

Çka paraqet qasja e bazuar në të drejtat e njeriut?
Zhvillimi i qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut
Poseduesit e të drejtave përkundër bartësve të detyrave

Përkufizimi i qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut

Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut (QBDNJ) është një metodë për integrimin e të drejtave të njeriut në punën e përditshme². Nuk ekziston një përkufizim i vetëm dhe i njësuar, por ekzistojnë elemente të caktuara, të cilat konsiderohen si thelbësore dhe sipas të të cilave dallohet nga qasjet tjera në zbatimin e programeve dhe projekteve zhvillimore. QBDNJ përfshin *integrimin e ndërgjegjshëm dhe sistematik të të drejtave të njeriut në të gjitha aspektet e zhvillimit dhe zbatimit të projekteve dhe programeve*³. QBDNJ paraqet një kuadër të programeve dhe projekteve të përmendura, i cili *mbështetet në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut* (Kapitulli 3) dhe është orientuar në mënyrë operative drejt avancimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut⁴. QBDNJ **nuk fokusohet vetëm në qëllimet dhe rezultatet e punës, por edhe në procesin**, dhe në mënyrën si parimet e të drejtave të njeriut (Kapitulli 2) janë inkorporuar në punën e përditshme.

Edhe pse nevoja për integrimin e të drejtave të njeriut në programet e zhvillimit ekziston që moti, qasja e bazuar në të drejtat e njeriut për herë të parë merr një përfshirje të përkufizuar qartë në një dokument të OKB, të titulluar si *Statement of Common Understanding*⁵. Ky dokument ngërthen në vete tre elemente kryesore, të cilat përbëjnë QBDNJ:

- 1 | Të gjitha programet dhe politikat zhvillimore, si dhe asistencat teknike duhet ta avancojnë realizimin e të drejtave të njeriut, të përcaktuara me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe me instrumentet tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut,
- 2 | Të drejtat e njeriut të përfshira në, dhe parimet që dalin nga, Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut,⁶ dhe me instrumentet tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilët orientojnë bashkëpunimin zhvillimor dhe programimin në të gjithë sektorët dhe në të gjitha fazat e procesit të programimit, dhe
- 3 | Bashkëpunimi zhvillimor kontribuon për zhvillimin e kapaciteteve të bartësve të detyrave, për t'i përbushur obligimet e veta dhe/ose të poseduesve të të drejtave, që ata t'i realizojnë të drejtat e veta.

2 UNFPA A Human Rights – Based Approach to Programming – Practical Implementation Manual and Training Materials, 2014. P. 70.

3 UNICEF Finland. Introduction to the Human Rights Based Approach – A Guide for Finish NGOs and their Partners. 2015. P.8

4 OHCHR, Frequently Asked Questions on a Human Rights-Based Approach to Development Cooperation, 2006.

5 UN Statement of Common Understanding on Human Rights-Based Approaches to Development Cooperation and Programming (the Common Understanding)

6 Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, OKB, 10 dhjetor 1948

QBDNJ përkundër të gjitha qasjeve tjera në programet zhvillimore

Njëjtë si çdo përpjekje tjetër për përmirësimin e gjendjes aktuale, QBDNJ paraqet një përpjekje për të përmirësuar gjendjen e njerëzve. Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut iu ndërlidhet qasjeve të bazuara në nevojat dhe mirëbërjes.

Aksi qëndror i qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut është se njerëzit gëzojnë të drejta të patjetërsueshme, dhe mospërbushja e këtyre të drejtave shpesh mund të trajtohet si mohim i së drejtës⁷.

Me fjalë tjera, uji i pijshëm i pastër jo vetëm se është diçka që na nevojitet, por ai është diçka për të cilën kemi të drejtë si qenie njerëzore. Kështu, përdorimi i nevojat elementare të njeriut janë baza e të drejtave të njeriut, janë disa dallime të konsiderueshme midis nevojave dhe të drejtave⁸:

- Të drejtat e njeriut mbikalojnë nevojat fizike dhe përfshijnë një perceptim më holistik të qenies njerëzore në raport me rolet e tij civile, politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore.
- Të drejtat çdoherë nënkuptojnë obligime dhe detyra të qarta, për dallim nga nevojat. Nuk mund të bëhet fjalë për të drejta, pa parashtruar pyetjen se kush mban obligimin për përmbushjen e këtyre të drejtave. Me këtë parashtrohet dhe pyetja për veprimet dhe përgjegjësinë e bartësve të detyrave.
- Nga njerëzit shpesh pritet të janë mirënjohës kur u përmbushen nevojat, por nuk ka një pritje të tillë në rastet kur janë përmbushur të drejtat e tyre. Kjo na e rikujton që të mos angazhohemi për “ata që kanë nevojë”, por duhet t’i mbështesim personat e marginalizuar si qenie njerëzore të barabarta në luftën e tyre për realizimin e të drejtave të tyre dhe ta targetojmë varfërinë, vuajtjet dhe padrejtësitë në jetët e tyre.

Ndryshimi në të menduarit i cili po aplikohet me QBDNJ më së miri mund të shihet kur krahasohet me qasjet tradicionale të bazuara në mirëbërje ose në nevoja:

Mirëbërja/Charity	Nevojat/Need	Të drejtat/Rights
Fokusi në atë që jepet, jo në rezultatin	Fokusi edhe në atë që jepet edhe në rezultatin	Fokusi në mënyrën/procesin dhe në rezultatin
Thekson rritjen e mirëbërjes	Thekson përmbushjen e nevojave	Thekson realizimin e të drejtave
Identifikon obligimin moral të të pasurve ndaj të varfërve	Identifikon nevojat si kërkesa përkatëse	Identifikon të drejtat e individit dhe të grupit si kërkesa ndaj bartësve juridikë dhe moralë të obligimeve
Personat trajtohen si viktima	Personat janë lëndë e programeve për zhvillim	Personat dhe grupet janë fuqizuar për të kërkuar realizimin e të drejtave të tyre
Personat meritojnë asistencë	Personat meritojnë asistencë	Personat kanë të drejtë për asistencë
Fokusi në problemin	Fokusi në shkaqet e menjëhershme të problemit	Fokusi i shkaqeve strukturore dhe manifestimeve të tyre

⁷ Applying a rights-based approach - An inspirational guide for civil society, Jakob Kirkemann Boesen & Tomas Martin. Danish Institute for Human Rights. P.10

⁸ Ibid

Poseduesit e të drejtave dhe bartësit e detyrave

QBDNJ bën ndarje të qartë midis personave, të drejtat e të cilëve duhet të realizohen dhe subjektet që kanë detyrim juridik në sigurimin e realizimit të të drejtave. Kështu, QBDNJ bën dallimin *midis poseduesve të të drejtave dhe bartësve të detyrave*.

Poseduesit e të drejtave (Right holders)⁹ janë të gjithë njerëzit konform Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut. Në një nivel më konkret, ekzistojnë grupe shoqërore specifike, të drejtat e të cilave nuk respektohen plotësisht, e as nuk përmbushen ose mbrohen. Në këto grupe biejnë gratë dhe vajzat, fëmijët, pakicat etnike, personat me aftësi të kufizuara, personat LGBTI, migrantët dhe të rinjtë. Për shembull, fëmijët janë posedues të të drejtave, ndërsa prindërit e tyre konsiderohen si bartës të detyrave të rendit të parë, konform konventave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës – përkatësisht, prindërit kanë për obligim dhe detyrim t'i respektojnë, mbrojnë dhe përmbushin të drejtat e fëmijëve.

Shkurt, poseduesi i të drejtave:

- Gëzon të drejtën për të patur të drejtat e veta të njeriut, t'i kërkojë të drejtat e veta dhe të kërkojë përgjegjësi nga bartësit e detyrave,,
- Ka obligimin për të respektuar të drejtat e të tjerëve.¹⁰

Bartësit e detyrave (Duty bearers)¹¹ janë ata persona të cilët kanë obligim ose detyrim konkret për të respektuar, mbrojtur, avancuar dhe përmbushur të drejtat e njeriut, dhe të frenojnë nga shkeljet e të drejtave të njeriut. Termi "bartës i detyrave" më së shpeshti përdoret për organet shtetërore dhe organet tjera të autorizuara të të gjitha niveleve. Shteti është bartësi përfundimtar i detyrave, sepse ai ratifikon konventat ndërkombëtare. Është e domosdoshme të kuptohet se obligimi i shtetit rrjedh nga procesi i ratifikimit të instrumenteve ndërkombëtare. Në qoftë se shteti nuk ka ratifikuar ndonjë Konventë të caktuar, për atë shtet nuk ekziston një obligim juridiksht i detyrueshëm, dhe kundër sjelljes së tij nuk mund të ndërmerren të njëjtat masa të cilat do të ishin ndërmarrë kundër shteteve të cilat kanë ratifikuar Konventën në fjalë.

Edhe entitete tjera, të cilat nuk janë vetë shteti, poashtu do të kishin mund të ishin bartës të detyrave. Varësisht nga konteksti dhe situata, individët, siç janë prindërit, organizatat lokale, kompanitë private, dhënësit e ndihmës, institucionet ndërkombëtare, grupet rebeluese, forcat e armatosura dhe të tjerë, poashtu mund të jenë bartës të detyrave.

9 UNICEF Finland. Introduction to the Human Rights Based Approach – A Guide for Finish NGOs and their Partners. 2015. P.8

10 Applying a rights-based approach - An inspirational guide for civil society, Jakob Kirkemann Boesen & Tomas Martin. Danish Institute for Human Rights. P.10

11 UNICEF Finland. Introduction to the Human Rights Based Approach – A Guide for Finish NGOs and their Partners. 2015. P.8, и Applying a rights-based approach - An inspirational guide for civil society, Jakob Kirkemann Boesen & Tomas Martin. Danish Institute for Human Rights, P. 13

Përfitimet nga aplikimi i QBDNJ¹²

Përfitimet nga përdorimi i QBDNJ në punën e përditshme, janë këto në vijim:

Përforcon realizimin e të drejtave të njeriut dhe përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut.

Përmirëson transparencën.

Promovon rezultatet dhe është integruar me menaxhmentin e bazuar në rezultate, që siguron matjen e efektshmërisë.

Redukton cenueshmërinë përmes fokusit në grupet e marginalizuara dhe të përjashtuara shoqërore.

Rrit përgjegjësinë.

Mundësia e rritur e arritjes së ndryshimeve të qëndrueshme shoqërore.

Ofron kuadrin për adresimin e problemeve të personave më të varfër dhe më të cenueshëm.

Rrit dhe përforcon pjesëmarrjen e komunitetit lokal

Ofron një perspektivë dinamike të varfërisë, e cila përfshin ekuilibrin e fuqisë dhe politikës, përmes përfshirjes së të drejtave të patjetërsueshme dhe të pandashme

Identifikon varfërinë jo si një rrethanë personale, por si pjesë e kontekstit më të gjerë, duke përfshirë komunitetin, qeverinë kombëtare dhe komunitetin ndërkombëtar.

Identifikon dhe ndihmon shtetet në përmbushjen e obligimeve të tyre, të cilat rrjedhin nga instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Ofron një fokus më të mirë në arsyt elementare për varfërinë, me anë të theksimit të përgjegjësisë së bartësve të detyrave.

Mundëson fuqizimin përmes vendosjes së raporteve të përgjegjësisë midis strukturave shtetërore, grupeve shoqërore dhe individit.

Ofron legjitimitetin përmes një kuadri të përbashkët të zhvillimit, të pranuar ndërkombëtarisht.

12 UNICEF Finland. Introduction to the Human Rights Based Approach – A Guide for Finish NGOs and their Partners. 2015. P.10

Kapitulli 2:

Parimet bazë të qasjes së
bazuar në të drejtat
e njeriut


Cilat janë parimet e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut?

Si aplikohen këto parime në praktikë?

Prirja ndaj mbrojtjes së dinjitetit njerëzor të të gjithë qenieve njerëzore gjendet në mesin e konceptit të të drejtave të njeriut, koncept ky i cili vendos njeriun si individ në qendrën e vëmendjes. Kuptimi i parimeve dhe procedurave lidhur me të drejtat e njeriut aftëson njerëzit që të marrin pjesë në vendimet shoqërore, të cilat ndikojnë mbi jetët e tyre, si dhe të veprojnë në drejtimin e zgjidhjes së konflikteve dhe mbarëvajtjen së paqes.

Standardet e të drejtave të njeriut, si dhe parimet që janë përfshirë me, ose që rrjedhin nga Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, konventat e KB dhe dokumentet tjera ndërkombëtare për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut formojnë parimet e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut (QBDNJ). Këto parime mund të aplikohen në tërë planifikimin strategjik të organizatës dhe procesit të përgjithshëm të planifikimit programor, duke përfshirë këtu vlerësimin dhe analizën, planifikimin dhe zbatimin e projekteve, sigurimin e shërbimeve, si dhe vëzhgimin dhe vlerësimin. Në këtë mënyrë, QBDNJ mundëson organizatën jo vetëm të ketë parimet kryesuese në strategjinë e vet, por edhe ta udhëheqë mënyrën me të cilën organizata zbaton aktivitetet në punën e vet.

Me qëllim kuptimi më i mirë i asaj se si QBDNJ mund të shfrytëzohet nga organizatat e shoqërisë civile, është me rëndësi të shënohen parimet mbi të cilat pushon kjo qasje. Kështu, parimet bazë të QBDNJ janë: universaliteti; patjetërsueshmëria; pandashmëria; ndërvartësia dhe lidhja e ndërsjellë; pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje; mosdiskriminimi dhe barazia; përgjegjësia dhe sundimi i ligjit; si dhe transparencia dhe aksesimi në informacione.



Universaliteti dhe patjetërsueshmëria

Përderisa **universaliteti** nënkupton plotësi të të drejtave dhe përfshin rëndësinë absolute të të drejtave për gjithësecilin, gjithkund dhe në çdo kohë, si dhe faktin se të drejtat fitohen me lindjen e çdo qenieje njerëzore, **patjetërsueshmëria** nënkupton se të drejtat e njeriut nuk mund të revokohen, e as të pushohet vlefshmëria e tyre nën asnjë rrethanë. Sipas këtyre parimeve, çdo person, pavarësisht nga vendi dhe koha e lindjes, pavarësisht nga ngjyra e lëkurës, gjinia, orientimi seksual, aftësia e kufizuar fizike dhe mendore ose nga çfarëdo dallimi tjetër, gëzon të njëjtat të drejta themelore të njeriut, në masë të njëjtë si gjithë personat tjerë. Në këtë kuptim, Neni 1 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut i KB lexon se “të gjitha qeniet njerëzore lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta”.

Pandashmëria

Pandashmëria nënkupton se të gjitha të drejtat e njeriut po gëzohen së bashku, përkatësisht, “pavarësisht nëse janë të natyrës civile, kulturore, ekonomike, politike ose sociale, paraqesin pjesë përbërëse të dinjitetit të çdo qenieje njerëzore. Si rezultat i kësaj, të gjithë kanë statusin e njëjtë si të drejta dhe nuk mund të renditen me hierarki”¹³. Ky parim siguron mbrojtje të barabartë të të gjitha të drejtave të njeriut dhe nxit përpjekjet e bartësve të detyrave për të krijuar mundësi të barabarta në realizimin e këtyre të drejtave. Parimi i ndërvartësisë dhe lidhshmërisë së ndërsjellë ndjek parimin e pandashmërisë dhe nënkupton se realizimi i një të drejte varet nga realizimi i të drejtave tjera, gjegjësisht, shkelja e një të drejte shkakton shkeljen edhe e të drejtave tjera. Kështu, për shembull, nëse dikujt i pamundësohet realizimi i së drejtës së arsimimit, kjo pashmangshëm do të ndikojë në të drejtën e tyre të shëndetësisë, të drejtën e mirëqenies, të drejtën e punës, të drejtën e informimit, të drejtën e privatësisë, dhe kështu me radhë.

Pjesëmarrja

Gjithësecili ka të drejtë të **pjesëmarrjes** aktive, të lirë dhe të rëndësishme në proceset e marrjes së vendimeve, të cilët do të ndikojnë mbi jetën shoqërore të atij personi. Nga pikëpamja e QBDNJ, pjesëmarrja nuk është vetëm një mjet teknik që përdoret në planifikimin ose zbatimin e aktiviteteve, por ajo është edhe e drejtë edhe detyrim për inkuadrimit aktiv e të gjithë bartësve të identifikuar të të drejtave dhe bartësve të detyrave në të gjitha fazat e planifikimit, monitorimit dhe vlerësimit. Mundësimi i pjesëmarrjes në proceset e vendimmarrjes është baza e qytetarisë aktive. Pjesëmarrja dhe inkuadrimi janë posaçërisht të rëndësishme për fuqizimin e subjekteve të marginalizuara, të përjashtuara dhe të padukshme në shoqëri.

Barazia

Barazia, në kuptimin më të gjerë, paraqet garanci për mbrojtjen nga sjellja diskriminatore ndaj individëve, pavarësisht nëse është ai diskriminim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë. Parimi i barazisë është parim bazë i të drejtave të njeriut, i cili pushon mbi vlerën dhe dinjitetin e barabartë e të gjithë qenieve njerëzore. Të gjithë njerëzit kanë të drejtë t'i praktikojnë të drejtat e tyre të njeriut, pa u diskriminuar në bazë të racës, seksit, gjinisë, moshës, gjuhës, fesë, përcaktimit politik, bindjeve dhe mendimeve, origjinës kombëtare ose sociale, aftësisë së kufizuar, gjendjes pronësore, statusit shëndetësor, orientimit seksual ose çfarëdo baze tjetër (kjo listë është inkluzive dhe e hapur), siç është përcaktuar me dokumentet ndërkombëtare dhe interpretuar nga organet e përcaktuara me këto dokumente. QBDNJ i kushton vëmendje të posaçme bërjes ballë diskriminimit dhe jobarazisë, andaj, sipas këtij parimi, të dhënat duhet të risegregohen sa është e mundshme më tepër (për shembull, sipas seksit, fesë, përkatësisë etnike, gjuhës dhe aftësisë së kufizuar), me qëllim dhënia e dukshmërisë së të gjitha grupeve të marginalizuara, të identifikuar si posedues të të drejtave. «Veç kësaj, të gjitha vendimet për zhvillim, politikat dhe iniciativat në të njëjtën kohë kërkojnë nxitjen e prerë e aktorëve lokalë, të cilët janë të detyruar ta mbrojnë veten nga fuqizimi i mosekuilibrit të fuqisë, ose të kontribuojnë për krijimin e fuqive të reja»¹⁴.

13 United Nations Children's Fund/ United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization, A Human Rights-Based Approach to Education, 2007, стр. 10

14 United Nations Children's Fund/ United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization, A Human Rights-Based Approach to Education, 2007, стр. 11

Llogaridhënia/përgjegjësia

Parimit e qeverisjes së mirë kërkojnë nga palët e interesuara të jenë **llogaridhënese** dhe **të përgjegjshme** për rezultatet e arritura. QBDNJ përpunon këtë parim të përgjegjësisë, duke fuqizuar plotësisht atë nëpërmjet risegregimit të bartësve të të drejtave dhe bartësve të detyrave, si dhe me anë të ndërlikimit të përgjegjësisë me të drejtat dhe detyrimet specifike të njeriut, të përcaktuara me të drejtën e brendshme dhe atë ndërkombëtare. "Shtetet dhe institucionet e tyre, organet lokale dhe të tjera, komunitetet dhe individët (bartësit e të drejtave dhe bartësit e detyrave) – janë të gjithë përgjegjës për realizimin e të drejtave të njeriut. Është me rëndësi të theksohet se QBDNJ nuk është vetëm mjet i fuqizimit të kapaciteteve të bartësve të të drejtave, por edhe mjet i fuqizimit të kapaciteteve të bartësve të detyrave, me qëllim përmbushja përkatëse e detyrave të tyre. Fuqizimi i kapaciteteve të tyre do ta rrisë llogaridhënien dhe përgjegjësinë e tyre, duke patur parasysh se bartësit e detyrimit nganjëherë përballen me mungesën e resurseve, njohurive dhe ekspertizës për interpretimin e të drejtave të njeriut ose aplikimin e QBDNJ"¹⁵.

Në të gjitha vendet demokratike, **e drejta e aksesit të lirë në informacione me karakter publik**, dhe liria për të pranuar dhe transmetuar informacione janë përcaktuar si e drejtë themelore e njeriut. Sipas rregullave të brendshme, për arsye të transparencës sa më të madhe të institucioneve shtetërore të financuara nga Buxheti i Maqedonisë, qytetarët gëzojnë të drejtën të kërkojnë raport për punën e tyre, nëpërmjet aksesit në informacione me karakter publik, ndërsa institucionet kanë për obligim t'u japin përgjigje qytetarëve dhe akses në informacione, të përcaktuara me ligj. Kërkesë për akses të lirë në informacione me karakter publik mund ta parashtrorë çdo person fizik ose juridik. Kjo do të thotë se çdo person, pavarësisht nga statusi i tij të shtetësisë, mund të kërkojë akses të lirë në informacione me karakter publik.

Nuk lejohet diskriminimi i kërkuar në bazë të gjinisë, racës, fesë, mendimit politik, e as në ndonjë bazë tjetër. QBDNJ përcakton këtë parim në mënyrë që bartësit e detyrave janë të detyruar t'i vënë në dispozicion të gjitha informacionet me karakter publik, dhe me këtë, duhet t'i marrin parasysh grupet e ndryshme të qytetarëve, si dhe nevojat dhe mënyrat e ndryshme, me qëllim që çdo anëtar i këtyre grupeve do të mund t'i praktikojë të drejtat e veta, në mënyrën përkatëse. Ky parim është i lidhur ngushtë me parimin e llogaridhënies, sepse vetëm përmes çiltërsisë dhe aksesueshmërisë në informacionet që kanë të bëjnë me punën e institucioneve, qytetarët ose bartësit tjerë të të drejtave mund t'i vlerësojnë bartësit e detyrave, duke influencuar kështu punën e tyre, gjë kjo me të cilën, në shkallë të fundit, përforcohet llogaridhënia dhe përgjegjësia e bartësve të detyrave.

Parimet e lartpërmendura mund të prezantohen përmes një shembulli konkret:

E drejta e arsimit u takon barazisht të gjithë njerëzve, ndërsa bartësit e detyrave (siç janë Ministria e Arsimit, shkollat, komunat, etj.) janë të detyruar t'u mundësojnë të gjithë bartësve të të drejtave që ta ushtrojnë këtë të drejtë. Shumë shpesh, pa aplikimin e QBDNJ, programimi i aktiviteteve për përmirësimin e gjendjes në lidhje me realizimin e së drejtës së arsimit, jo qëllimshëm janë orientuar drejt grupeve jo të marginalizuara, dhe kështu, ato janë më të aksesueshme dhe më tepër të orientuara drejt zonave urbane, për dallim nga aksesueshmëria e tyre për qytetarët e zonave urbane, ose për pjesëtarët e grupeve të marginalizuara, siç janë për shembull personat me nevoja të posaçme, gratë pjesëtare të grupeve etnike pakicë, e ngjashëm. Kështu për shembull, pa aplikimin përkatës të QBDNJ, gjatë aplikimit të TI në shkollat në Maqedoni, nuk u morën parasysh nevojat e posaçme të nxënësve me shikim të dëmtuar, ose me aftësi të kufizuar trupore, kështu që këto reforma në arsim ishin më të vështira për aksesueshmërinë e këtyre grupeve të nxënësve. Ky akses i bartësve të detyrave plotësisht do ta rrisë jobalancin e fuqisë dhe jobarazinë midis grupeve të ndryshme të qytetarëve. Me aplikimin e QBDNJ, gjegjësisht përmes risegregimit të bartësve të të drejtave, mundësohet pjesëmarrja e barabartë e të gjitha grupeve të qytetarëve, dhe në të njëjtën kohë, merren parasysh nevojat e ndryshme dhe mënyrat e ndryshme të realizimit të fuqizimit të të drejtave të të gjitha grupeve të qytetarëve, duke pranuar kështu barazinë, universalitetin, patjetërsueshmërinë dhe pandashmërinë e të drejtave. Nga ana tjetër, QBDNJ mundëson identifikimin e të gjithë bartësve të detyrave, me qëllim gjetja e mënyrave më përkatëse për fuqizimin e kapaciteteve të tyre, si dhe kanalet e komunikimit midis bartësve të detyrave dhe bartësve të të drejtave. Në këtë mënyrë sigurohet pjesëmarrja përkatëse e të gjithë bartësve të të drejtave dhe bartësve të detyrave në procesin e planifikimit, zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit, ku e drejta e arsimit (në këtë shembull), mund të jetë barabartësisht e aksesueshme dhe e praktikuar nga të gjitha grupet e qytetarëve. Duke patur parasysh parimin e lidhjes së ndërsjellë së të drejtave, me anë të fuqizimit të së drejtës së arsimit poashtu do të fuqizohen dhe të drejtat tjera të të gjitha grupeve të qytetarëve, gjë kjo e cila plotësisht do ta pakësojë jobalancin e fuqisë dhe do ta përforcojë barazinë midis grupeve të ndryshme të qytetarëve.

15 Union of Citizens' Associations "Macedonian Platform against Poverty" - PRINCIPLES AND GUIDELINES ON ACCESS TO HUMAN RIGHTS, 2010, p. 18

Kapitulli 3:

Liritë dhe të drejtat
themelore të njeriut dhe
qytetarit të njohura me të
drejtën ndërkombëtare

Konceptet themelore të dinjitetit të njeriut

Të drejtat e njeriut paraqesin arritjen më të lart filozofike të kohës moderne. Si të tilla, të drejtat e njeriut paraqesin sistemin e vetëm të vlerave, i cili ka vlefshmëri universale. Jeta e njeriut është nën ndikimin e të drejtave dhe detyrimeve morale dhe ligjore nga më të ndryshmet, megjithatë, vetëm një grup i caktuar është kodifikuar në kushtetutat e shteteve, si dhe në një numër të marrëveshjeve ndërkombëtare. Përkundër asaj se ato janë mishëruar në mënyrë efektive si norma ligjore në kushtetutat e të gjitha kombeve në botë, me nënshkrimin dhe ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, të gjitha kombet në botë janë të detyruara t'i respektojnë, mbrojnë dhe përmbushin të drejtat themelore të njeriut.

Në praktikë, të drejtat e njeriut përcaktojnë standardet dhe rregullat minimale të procedurës, nën të cilat autoritetet patjetër duhet t'i respektojnë gjatë procedimit me njerëzit nën kompetencat e tyre. Kjo më së shpeshti u përket qeverive, policisë, forcave të armatosura e ngjashëm, por me aplikueshmërinë e tyre, kompetenca shtrihet edhe tek subjektet joqeveritare, siç janë organizatat ndërkombëtare, sektori privat, komunitetet fetare e të tjerë, të cilët kanë autorizime mbi persona tjerë.¹⁶ Nga njëra anë, të drejtat e njeriut kufizojnë autorizimet e autoriteteve, ndërsa në anën tjetër, vendosin bazat për fuqizimin dhe mundësimin e aksesit për njerëzit në realizimin e të drejtave të tyre.

Fokusi qëndror i të drejtave të njeriut është mbrojtja e jetës dhe dinjitetit të njeriut. Neni 1 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut lexon: "Të gjitha qeniet njerëzore lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe të drejta. Ata janë të pajisur me arsye dhe ndërgjegje dhe duhet ta trajtojnë njëri tjetrin në frymën e vëllazërimit."

Shkelja e dinjitetit të njeriut paraqitet kur, për shembull, individët janë të torturuar, të robëruar, trafikohen si pronë, kur vriten, degradohen ose diskriminohen. Dinjiteti i njeriut poashtu shkelet në qoftë se njerëzit janë të detyruar të jetojnë në varfëri absolute. Nga këto të drejta themelore të njeriut dalin të drejta tjera, siç është e drejta e lirisë dhe barazisë, të drejtat politike, të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, të drejtat kolektive, të drejtat procedurale dhe të drejtat specifike të grupeve të cënueshme dhe të marginalizuara.¹⁷

Përveç asaj se janë rrënjësor në dinjitetin e njeriut, të drejtat e njeriut janë poashtu univernale dhe të patjetërsueshme, të varura mes vete dhe të pandashme. Universaliteti i përket pohimit se ato duhet të gëzohen nga të gjithë, pa përjashtim. I tërë supozimi bazohet në faktin se individit ka të drejtën që t'i gëzojë këto të drejta me vetë faktin se është qenie njerëzore.¹⁸ Patjetërsueshmëria do të thotë se të drejtat e njeriut nuk mund të dorëzohen ose të kalohen, e as edhe një organ nuk mund t'ia mohojë asnjë njeriu. Pandashmëria bazohet mbi vartësinë e ndërsjellë e të drejtave individuale, që do të thotë se, me qëllim garantimi i të drejtave civile dhe politike, Qeveria patjetër duhet siguruar të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (dhe e kundërta). Parimi i pandashmërisë nisët nga qëndrimi se shkelja e një të drejte, siç është shëndetësia për shembull, si çrregullim konsekuent i aftësisë efektive të individit për t'i realizuar të drejtat tjera, siç është e drejta e jetës.

16 Austrian Development Agency. (2010). Human Rights Manual: Guidelines for implementing a Human Rights Based Approach in ADC. Retrieved from https://www.entwicklung.at/fileadmin/user_upload/Manual_Human_Rights.pdf

17 Ibid

18 OHCHR Website. (n.d.) What are human rights. Retrieved from <https://www.ohchr.org/EN/Issues/Pages/whatarehumanrights.aspx>

Përshkrimi i lirive dhe i të drejtave themelore të njohura me të drejtën ndërkombëtare


Të drejtat dhe liritë themelore mund të ndahen në tetë grupe, gjegjësisht, të drejtat dhe liritë civile, barazia, të drejtat politike, të drejtat ekonomike, të drejtat sociale dhe kulturore, të drejtat kolektive, të drejtat procedurale dhe të drejtat specifike të grupeve të cenueshme dhe të marginalizuara.

Të drejtat dhe liritë civile:



E drejta e privatësisë, e drejta e lëvizjes, e drejta e mendimit, ndërgjegjes, bindjes fetare, shoqërimit, e drejta e jetës, integriteti personal

Barazia:



Barazia përpara ligjit, mbrojtja nga diskriminimi në bazë të gjinisë, moshës, ngjyrës së lëkurës, fesë, origjinës etnike dhe statusit social, mendimit politik, aftësisë së kufizuar ose orientimit seksual

Të drejtat politike:



E drejta e votës, aksesit i barabartë në gjykatë, liria e shoqërimit politik, e drejta e zgjedhjes dhe i të qenit të zgjedhur

Të drejtat ekonomike:



E drejta e pronësisë, e drejta e tregut, liria e shoqërimit, liria e dhënies së shërbimeve, e drejta e organizimit sindikal, e drejta e punës, liria e zgjedhjes në punësim dhe kushtet adekuate të punës

Të drejtat sociale dhe kulturore:



E drejta e jetës, ushqimit, ujit, banimit, veshjes, shëndetësisë, arsimit dhe sigurimit social

Të drejtat kolektive:



E drejta e vetëvendosjes së popujve, e drejta e zhvillimit dhe e mjedisit të shëndetshëm jetësor

Të drejtat procedurale:



E drejta e aksesit të barabartë në drejtësi dhe gjykim të drejtë, sidomos në procedurat penale

Të drejtat specifike të grupeve të cenueshme:



Fëmijët, personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara, të huajt, refugjatët, personat indigjenë dhe grupet tjera të cenueshme

Marrëveshjet (dokumentet) ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

• Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut

Themeli i aktiviteteve të KB është padyshim Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e KB më 10 dhjetor të vitit 1948. Synimi i saj nuk ka qenë të jetë një dokument juridikisht i detyrueshëm, por, siç është proklamuar në preambulë: “standard i përbashkët i arritjeve për të gjithë popujt dhe kombet”.¹⁹ Tridhjetë nenet përfshijnë një spektër të gjerë të të drejtave, duke u nisur nga liria dhe siguria e personalitetit (Neni 3), barazia përpara ligjit (Neni 7), mjetet efektive juridike (Neni 8), procesi i qëndrueshëm (Neni 9 dhe të tjerë), ndalimi i torturës (Neni 14), shprehja (Neni 19), ndërgjegjia dhe konfisioni fetar (Neni 18) dhe tubimi (Neni 20).²⁰ Në Deklaratë janë përfshirë edhe të drejtat sociale dhe ekonomike.

Edhe pse nuk është dokument juridikisht i detyrueshëm, Deklarata konsiderohet si universalisht e detyrueshme, për shkak të statusit të saj të së drejtës zakonore, gjegjësisht, përmes parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose përmes interpretimit të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Në vitin 1986, gjatë Konferencës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut në Teheran, u konkludua se Deklarata paraqet “obligim për të gjithë anëtarët e komunitetit ndërkombëtar”.²¹ Deklarata, së bashku me Traktatin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Traktatin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe dy protokollet e tij opsionalë, janë të njohura si Karta Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.

• Traktati Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (ICESCR)

Traktati Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e KB në vitin 1966 dhe hyri në fuqi në vitin 1976. Neni 2 i Traktatit detyron çdo vend nënshkrues t'i ndërmarrë të gjitha hapat, duke përdorur në masën më të madhe të mundshme burimet e veta, “për të arritur realizimin gradual të të drejtave të pranuar me këtë Traktat...”. Domethënë, në lidhje me të drejtat që ngërthen në vete, Traktati, në vend se të imponojë detyrime të menjëhershme ligjore, ai parashikon një program zhvillimi, i cili varet nga resurset me të cilat disponojnë vendet nënshkruese. Të drejtat që përmban Traktati përfshijnë vetëvendosjen (Neni 1), të drejtën e punës (nenet 6 dhe 7), të drejtën e sigurimit social (Neni 9), standardin përkatës të jetesës (Neni 11) dhe të drejtën e arsimit (Neni 13), si dhe të drejtën e pjesëmarrjes në të gjitha aspektet e jetës kulturore dhe të drejtën që çdo person të shërbehet me arritjet e shkencës dhe aplikimin e tyre (Neni 15).

• Traktati Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR)

Në vitin 1966, Asambleja e Përgjithshme miratoi Traktatin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Traktatin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, përmes të të cilave, idealet e themeluara në Deklaratën Universale, u shndërruan në norma pozitive konkrete. Traktati për të Drejtat Civile dhe Politike identifikon dinjitetin indigjen të çdo individi dhe promovon krijimin e kushteve në çdo vend, me qëllim ushtrimi i të drejtave civile dhe politike. Vendet nënshkruese që ratifikuan Traktatin detyrohen “t'i mbrojnë dhe garantojnë të drejtat themelore të njeriut” dhe detyrohen të ndërmarrin masa administrative, gjyqësore dhe ligjvënëse me qëllim mbrojtja e të drejtave të përcaktuara me Traktatin dhe të sigurojnë mjet juridik në rast të shkeljes”. Traktati thirret në parimet e mosdiskriminimit të përfshira me Nenin 2 dhe Nenin 3. Të drejtat e përfshira me këtë instrument shtrihen nga e drejta e jetës (Neni 6), ndalimi i torturës (Neni 7), e drejta e lirisë dhe sigurisë personale (Neni 9), e drejta e personave të paraburgosur (Neni 10), e drejta e tubimit të paqshëm (Neni 21), ndalimi i propagandës në favor të luftës (Neni 20), e drejta e lidhjes së martesës (Neni 23), të drejtat e fëmijës (Neni 24), mbrojtja e të drejtave të pakicave (Neni 27).²²

19 Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.

20 Shaw, M. (2008). *International Law*. Cambridge University Press

21 Ibid

22 Traktati Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

Protokolli i parë Opsional:

Protokolli i parë Opsional shërben si instrument, i cili lejon personat të drejtat e të cilëve janë shkelur, të marrin zërin. Komiteti i të Drejtave të Njeriut, i cili është themeluar përmes Traktatit, ka kompetenca për të pranuar dhe shqyrtuar parashtrësit e viktimave. Protokolli i parë Opsional hyri në fuqi së bashku me Traktatin.²³

Protokolli i dytë Opsional:

Protokolli i dytë Opsional i Traktatit synon pezullimin e dënimit me vdekje. Protokolli i miratua nga Asambleja e Përgjithshme më datë 15 dhjetor të vitit 1989.²⁴

- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit Racor (CERD)

Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit racor u miratua në vitin 1965 dhe hyri në fuqi në vitin 1969. Konventa po mbështetet mbi parimet e mosdiskriminimit në Kartën e KB. Diskriminimi racor përkufizohet si:

“...çdo bërje e dallimit, përjashtimit, kufizimit ose dhënia e përparësisë që bazohet mbi racën, ngjyrën, paraardhësit, origjinën kombëtare ose etnike, që ka për qëllim ose jep rezultatin e çrregullimit ose kompromitimit të njohjes, ushtrimit ose kryerjes, nën kushte të barabarta, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në fushën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, ose në çdo fushë tjetër të jetës publike.”²⁵

Konventa detyron vendet nënshkruese, në kuadrin e kompetencave të tyre, për ndalimin e diskriminimit dhe garantimin e trajtimit të barabartë në ushtrimin e të drejtave që dalin nga Konventa, dhe për sigurimin e mbrojtjes efikase dhe mjetit efektiv juridik në rast të shkeljes së të drejtave.

- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW)

Më 18 dhjetor të vitit 1979, Asambleja e Përgjithshme miratoi Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, e cila hyri në fuqi më 3 shtator të vitit 1981. Konventa, e bazuar mbi Deklaratën Universale dhe Kartën e Kombeve të Bashkuara, përcakton të drejtat e barabarta të burrave dhe grave dhe i referohet mënyrimit të çfarëdo diskriminimi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndaj grave. Vendet nënshkruese të CEDAW kanë për obligim të luftojnë kundër diskriminimit, për ta siguruar kështu implementimin e Konventës. Kështu, ato i janë përkushtuar marrjes së aktiviteteve përkatëse në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave civile, kulturore, ekonomike, sociale dhe politike të grave, me anë të miratimit të ligjeve dhe politikave që adresojnë të drejtën e punës, të drejtën e pronës, të drejtën e lirisë së shprehjes, të drejtën e arsimit dhe të drejtën e mosdiskriminimit, mes tjerash.²⁶

- Konventa për të Drejtat e Fëmijës (CRC)

Konventa për të Drejtat e Fëmijës u miratua më 20 shtator të vitit 1989, dhe hyri në fuqi më 2 shtator të vitit 1990. Komiteti për të Drejtat e Fëmijëve i OKB përkufizon fëmijën si çdo person në moshë nën 18 vjeç (Neni 1).²⁷ Konventa njihet rolin primar të prindërve dhe familjes në përkujdesjen për fëmijët dhe ua vë si obligim vendeve nënshkruese kryerjen e këtyre detyrave. Konventa përbëhet nga 41 nene, të cilat bazohen mbi nocionet e mbijetesës, zhvillimit, mbrojtjes dhe pjesëmarrjes. Parimet e përgjithshme të Konventës ndërtohen rreth 4 neneve, gjegjësisht, Neni 2, i cili garanton se të gjitha të drejtat e përcaktuara me Konventën janë domosdo në dispozicionin e të gjithë fëmijëve, pa diskriminim të asnjë lloji, Neni 3, i cili përcakton se mirëqenia e fëmijës është domosdo primare në të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me fëmijët, Neni 6, i cili përcakton se çdo fëmijë ka të drejtën e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit, dhe Neni 12, i cili përcakton se qëndrimi i fëmijës domosdo të merret parasysh në të gjitha çështjet që kanë ndikojnë atë.²⁸

²³ Protokolli i parë Opsional ndaj Traktatit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

²⁴ Protokolli i dytë Opsional ndaj Traktatit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

²⁵ Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor.

²⁶ Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave.

²⁷ Konventa për të Drejtat e Fëmijës.

²⁸ Ibid.

- **Konventa kundër Torturës (CAT)**

Konventa kundër Torturës dhe kundër çdo veprimi ose ndëshkimi tjetër të vrazhdë, çnjerëzor ose degradues (Konventa kundër Torturës), u miratua nga Asambleja e Përgjithshme më 10 dhjetor të vitit 1984. Konventa hyri në fuqi më 26 qershor të vitit 1987. Në pjesën e parë, nga gjithsej tre pjesë, Konventa përkufizon torturën (Neni 1), dhe detyron palët që të ndërmarrin masa efikase për parandalimin e torturës të cilitdo lloji, nën territorin e jurisdiksionit të tyre (Neni 2). Në pjesën e parë poashtu janë ofruar dhe hapat e nevojshëm për marrjen e masave efektive dhe detyron shtetet t'i ekzaminonjë të gjitha akuzat për veprime të atij lloji, nën kompetencën e tyre (Neni 16).²⁹

Pjesa e dytë e Konventës rregullon raportimin dhe vëzhgimin e zbatimit të Konventës. Në këtë pjesë themelohet Komiteti kundër Torturës (Neni 17), vendoset dhe një mekanizëm plotësues për zgjidhjen e kontesteve midis vendeve anëtare (Neni 21) dhe u mundëson anëtareve t'i njohin kompetencat e Komitetit në pranimin e ankesave nga individë, e që kanë të bëjnë me shkeljen e Konventës (Neni 22). Ratifikimin, hyrjen në fuqi dhe amandamentet e Konventës i rregullon një palë e tretë dhe gërsheton një mekanizëm zgjedhor arbitrar për konteste (Neni 30).

- **Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre (MWC)**

Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre, u miratua nga Asambleja e Përgjithshme më 18 dhjetor të vitit 1990, dhe hyri në fuqi më 1 korrik të vitit 2003. Konventa imponon një sërë detyrimesh ndaj qeverive për të promovuar "kushte të përpikëta, të drejta, humane dhe ligjore" për migracionet ndërkombëtare të punëtorëve dhe të anëtarëve të familjeve të tyre.³⁰ Të drejtat themelore të njeriut shtrihen mbi gjithë punëtorët migrantë, si ata të dokumentuar, ashtu edhe ata të padokumentuar. Konventa po bën përpjekje të vendosë standarde minimale për mbrojtjen e punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre. Konventa përkufizon grupe të punëtorëve migrantë sipas kategorive specifike dhe përbëhet nga tetë pjesë: vëllimi dhe përkufizimet; mosdiskriminimi me respektimin e të drejtave; të drejtat e njeriut e të gjithë migrantëve; të drejtat tjera të migrantëve që janë të dokumentuar ose në gjendje të rregullt; dispozitat e aplikueshme për kategoritë specifike të migrantëve; promovimi i kushteve të përpikëta, të drejta, humane dhe ligjore në lidhje me migracionin ndërkombëtar; aplikimi i Konventës; dispozitat e përgjithshme; dhe dispozitat përfundimtare.

- **Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë (CED)**

Konventa Ndërkombëtare për mbrojtjen e të gjithë personave nga zhdukja me forcë, e hartuar si mekanizëm juridikisht i detyrueshëm për mbrojtjen e personave nga zhdukja, u miratua nga Asambleja e Përgjithshme e KB më 20 dhjetor të vitit 2006, ndërsa hyri në fuqi më 23 dhjetor të vitit 2010. Sipas Nenit 1 të Konventës, as edhe një person nuk guxon t'i nështrohet zhdukjes me forcë në as edhe një rrethanë të jashtëzakonshme, pavarësisht nëse vendi është në gjendje lufte ose nëse ekziston kërcënimi nga lufta.³¹ Jostabiliteti i brendshëm politik, ose ndonjë lloj tjetër i gjendjes së jashtëzakonshme nuk guxon të shfrytëzohet si arsyetim për zhdukje me forcë. Vendet nënshkruese janë të detyruara të sjellin ligje konkrete për ta identifikuar zhdukjen me forcë si vepër penale. Ato janë të detyruara t'i ekzaminonjë ankesat dhe denoncimet e zhdukjes me forcë dhe t'i ndëshkojnë personat përgjegjës. Detyrimet tjera janë të natyrës parandaluese, si për shembull, çdo kufizim i lirisë së lëvizjes bëhet në institucionet e autorizuara, në të cilat të gjithë personat e pranishëm janë të regjistruar. Veç kësaj, Konventa njuh të drejtën e viktimave dhe familjeve të tyre ta dijnë të vërtetën mbi rrethanat e personit të zhdukur.

29 Konventa kundër Torturës dhe Çdo Veprimi apo Ndëshkimi tjetër të Vrazhdë, Çnjerëzor ose Degradues

30 Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre

31 Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë

- **Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD)**

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara u aprovua nga Asambleja e Përgjithshme më 13 dhjetor të vitit 2006 dhe hyri në fuqi më 3 maj të vitit 2008. Qëllimi i kësaj Konvente, sipas Nenit 1, është të promovohet, mbrohet dhe sigurohet ushtrimi i plotë dhe i barabartë i të gjitha të drejtave dhe lirive të njeriut për gjithë personat me aftësi të kufizuara, dhe të promovohet respekti i dinjitetit të tyre indigjen. Parimet e përgjithshme të Konventës janë numëruar në Nenin 3: mosdiskriminimi, përfshirja e plotë dhe efektive dhe inkluzioni në shoqëri; respektimi i dallimeve dhe pranimi i personave me aftësi të kufizuara si pjesë e diferencës njerëzore; mundësitë e barabarta; aksesueshmëria; barazia midis burrit dhe gruas; dhe respektimi i kapaciteteve zhvillimore të fëmijëve me aftësi të kufizuar, si dhe e drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuar për ruajtjen e identitetit të tyre.³² Sipas Konventës, vendet nënshkruese janë të detyruara të "sigurojnë dhe të promovojnë realizimin e plotë e të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë personat me aftësi të kufizuara pa diskriminim të cilitdo lloji në bazë të aftësisë së kufizuar."

- **Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore**

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) është një nga dokumentet kryesore rajonale për të drejtat e njeriut. Është aprovuar nga Këshilli i Evropës në vitin 1950 dhe ajo paraqet dokumentin më të rëndësishëm për të drejtat e njeriut në Evropë. Vendos një numër të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut (të drejtën e jetës, ndalimin e torturës, ndalimin e skllavërisë dhe punës së detyruar, të drejtën e lirisë dhe sigurisë, të drejtën e gjyqimit të drejtë në afat të arsyeshëm, të drejtën e jetës private dhe familjare, të drejtën e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, të drejtën e shprehjes, të drejtën e martesës, lirinë e shoqërimit, të drejtën e mjetit efektiv juridik, ndalimin e diskriminimit, dhe të tjera). Të drejtat plotësuese janë përcaktuar me protokollat opsionale të Konventës. Si mekanizëm për zbatimin e Konventës, raste të shkeljes së të drejtave mund të paraqiten përpara Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg. Gjykata shqyrton ankesat e individëve, si dhe ankesat ndër-shtetërore. Me kërkesë të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, Gjykata mund të jep interpretimin e vet për ndonjë Nen të caktuar të Konventës ose të ndonjërit nga protokollat. Komiteti poashtu mund të kërkojë nga Gjykata edhe interpretimin e vendimeve. Me vendim të Gjykatës, palët në procedurë domosdo duhet t'i përmbahen vendimit dhe t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme. Sekretariati i Përgjithshëm mund të kërkojë nga palët të japin arsyetimin rreth mënyrës me të cilën legjislacioni i brendshëm siguron implementimin efektiv të neneve të Konventës dhe të protokolleve të saja.

Detyrimet e shteteve

Detyrimi themelor i shteteve në kuptimin e të drejtave të njeriut është implementimi i normave ndërkombëtare përmes sistemit juridik të brendshëm dhe institucioneve. Ky detyrim bazë pasqyrohet me urdhërimin e mjetit efektiv juridik nga organet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të vendosura nga konventat pas shtjerrjes së mjeteve të brendshme juridike. Me këtë, mjetet juridike të urdhëruara nga organet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut po plotësojnë boshllëkun në rastet kur mekanizmat e brendshëm dëshmojnë si joefektiv. Për këtë arsye, detyrimi i shteteve për të raportuar mbetet të jetë tipari kryesor i sistemit. Sipas Traktatit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, vendet nënshkruese "obligohen të paraqesin raporte për masat që kanë adoptuar, me të cilat krahasohen të drejtat e pranuar me këtë Traktat, si dhe për progresin e arritur në ushtrimin e këtyre të drejtave..."³³ Traktati Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventa kundër Torturës dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe protokollet e tyre opsionale kanë nene të ngjashme. Konventa për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (Neni 18), Konventa për Eliminimin e Diskriminimit Racor (Neni 9) dhe Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të tyre (Neni 73) urdhërojnë vendet nënshkruese të raportojnë për masat ligjvënëse, gjyqësore dhe administrative ose për masat tjera që kanë ndërmarrë për të vënë në efekt nenet e Konventave.

Mbikëqyrja e përmbushjes së obligimeve të shteteve që dalin nga instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut

Të gjitha konventat për të drejtat e njeriut të Kombeve të Bashkuara kanë komitete që monitorojnë progresin e implementimit, e që quhen organe mbikëqyrëse ose komitete vëzhguese.

Pas ratifikimit, qeveritë po obligohen të raportojnë përpara komiteteve të ndryshme vëzhguese për hapat që kanë ndërmarrë për t'i implementuar nenet e konventave. Kjo njihet si Sistem i Raportimit të shteteve. Sektori civil (OJQ) dhe organet tjera kombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe organet tjera ndërkombëtare mund të dërgojnë informacione që do të shqyrtohen nga komitetet gjatë vlerësimit të harmonizimit të vendit me standardet ndërkombëtare. Shpesh, raportimi i këtyre është në formë të Raportit nën Hije, i cili shërben si kundër-balanc i raportit të paraqitur nga shteti. Këto raporte mund të paraqiten ose individualisht nga një organizatë ose si raport i bashkuar/i përbashkët nga disa organizata. Komiteti pastaj u lëshon Komente Përfundimtare qeverive të shteteve për progresin që kanë arritur, ndërsa shtetet pajtohen për t'i adresuar ato. Komitetet relevante të Kombeve të Bashkuara poashtu lëshojnë Rekomandime të Përgjithshme për çështjet që ato konsiderojnë se duhet të elaborohen më tej.

Konventa për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, Konventa për Eliminimin e Diskriminimit Racor dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore poashtu kanë një procedurë të parashikuar, ku individë dhe/ose grupe mund të paraqesin ankesa për shkeljen e të drejtave të mbrojtura me konventat. Komitetet poashtu kanë të drejtë të ngrisin procedurë mbikëqyrëse në raste të shkeljes masovike ose sistematike të të drejtave të mbrojtura me konventat.

33 Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.

Kapitulli 4:

Grupet e cënueshme dhe të
margjinalizuara në
Republikën e Maqedonisë

Koncepti i cenueshmërisë është i lidhur me nocionet e përjashtimit social, varfërisë, diskriminimit dhe marginalizimit. Margjinalizimi ose përjashtimi social lidhet me procesin e vënies në pozitë inferiore, për shkak të mungesës së aksesit në të drejta, burime dhe mundësi. Është kjo arsyeja kryesore e cenueshmërisë, që i përket nënshtrimit ndaj një numri të madh të dëmeve të mundshme dhe pamundësisë së përbalimit përkatës të tyre.

“Cenueshmëria” është e rëndësishme: ajo ka të bëjë me identifikimin e bartësve të të drejtave, të cilët shpeshherë nuk janë në gjendje t'i përmbushin të drejtat e veta, andaj grupet që shpesh janë orientuar drejt mbështetjes së organizatave të shoqërisë civile, gjegjësisht, kuptimit të cenueshmërisë, paraqesin një kapacitet të rëndësishëm por organizatat e shoqërisë civile, dhe janë thelbësore në kuptimin e përmbushjes së misionëve dhe vizioneve të tyre.

Pranimi i kohezionit social, solidaritetit, përgjegjësisë për gjithësecilin, imponon pranimin e parë të sinqertë të realitetit të fatit dhe jetës së anëtarëve të shoqërisë sonë, që janë në gjendje më të pafavorshme.

Maqedonia ka segmente dhe grupe në shoqërinë e vet, që janë në gjendje posaçërisht të cenueshme. Këto grupe të posaçme, të cilat, për arsye të ndryshme, janë të pafuqishme dhe të cenueshme ose tradicionalisht janë viktime të shkeljeve dhe politikave, dhe si pasojë, kërkojnë mbrojtje të posaçme në përmbushjen e barabartë dhe efektive të të drejtave të tyre të njeriut.

Ky Manual elaboron disa grupe të cenueshme në Maqedoni, siç janë: personat që jetojnë në varfëri të skajshme, pjesëtarët e komunitetit etnik rom, fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara, popullsia LGBTI dhe personat e moshuar. Këto grupe janë grupet më të shpeshta të aktiviteteve dhe nismave të organizatave të shoqërisë civile në Maqedoni. Është e qartë se kjo nuk është një listë e shtjerrur e personave që kanë nevojë për mbrojtje të posaçme, sepse shumë grupe tjera të cilat nuk shqyrtohen në këtë pjesë vuajnë nga diskriminimi dhe skllavërimi.

Personat që jetojnë në varfëri të skajshme

∏Ekzistojnë qasje të ndryshme në përkufizimin e varfërisë. Sipas debateve të fundit në nivelin evropian, varfëria ndahet në dy lloje: varfëria absolute (ekstreme) dhe varfëria relative. Varfëria absolute është një masë e varfërisë në kuptimin e shumës së parave të nevojitura për përmbushjen e nevojave elementare, siç është ushqimi, veshja dhe streha. Koncepti i varfërisë nuk merret me cilësinë më të gjerë të jetesës ose me nivelin e përgjithshëm të jobarazisë në shoqëri. Kështu, koncepti nuk njeh se individët kanë nevoja të rëndësishme sociale dhe kulturore. Kjo dhe kritika të ngjashme me këtë çuan drejt zhvillimit të konceptit të varfërisë relative. Varfëria relative përkufizon varfërinë në kuptimin e statusit ekonomik të pjesëtarëve tjerë të shoqërisë: njerëzit janë të varfër nëse bien nën standardet jetësore e që jetojnë në një kontekst të caktuar shoqëror. Kritika e rëndësishme e të dy koncepteve është se ata në përmasa të mëdha merren me të ardhurat dhe shpenzimet.

Koncepti i përjashtimit social në masë të madhe u shfaq si reagim i këtij lloji të përkufizimit të ngushtë të varfërisë. Ai konsiderueshëm kontribuoi për përfshirjen e treguesve të shumëanshëm në kuptimin konceptual të varfërisë.

Sot konsiderohet se nuk mund të merret parasysh vetëm pjesa ekonomike e varfërisë. Varfëria është poashtu sociale, politike dhe kulturore. Veç kësaj, konsiderohet se ajo minon të drejtat e njeriut – të drejtat ekonomike (e drejta e punës dhe e të ardhurave të përshtatshme), të drejtat sociale (aksesi në mbrojtje shëndetësore dhe në arsim), të drejtat politike (liria e mendimit, shprehjes dhe shoqërimit) dhe të drejtat kulturore (e drejta e kultivimit të identitetit kulturor dhe e inkuadrimit në jetën kulturore të komunitetit).³⁴

Në Republikën e Maqedonisë, sipas të dhënave të fundit zyrtare të Entit Shtetëror të Statistikave, në vitin 2016, shkalla e personave të varfër arrinte 21.9%. Kjo do të thotë se 453 mijë persona në vend kanë jetuar në varfëri në vitin 2016, me më pak se 6.500 denarë për muaj (± 106 euro). Sipas statusit më frekuent të aktivitetit ekonomik, shkalla e personave të varfër të punësuar arrin 9.0%, ndërsa shkalla e pensionistëve të varfër arrin 7.1%. Pragu i varfërisë përkufizohet si nivel i standardit të jetës, që duhet të arrihet për një person/amvisëri të mos klasifikohet si i/e varfër dhe matet në formën e të ardhurave mujore nga 14.500 denarë (± 236 euro) për një familje katëranëtarëshe.³⁵

³⁴ UNESCO, Varfëria, e disponueshme në: <http://www.unesco.org/new/en/social-and-human-sciences/themes/international-migration/glossary/poverty/>

³⁵ Enti Shtetëror i Statistikave, e disponueshme në: <http://www.stat.gov.mk/PrikaziSoopstenie.aspx?rbrtxt=115>

Gjithashtu, është e domosdoshme të shënohet qëndrimi shqetësueshëm i rëndë i grave rome, të cilat shpesh përballen me diskriminim të shumëfishtë – në bazë të gjinisë dhe origjinës etnike – si dhe me shkelje tjera të të drejtave të njeriut për arsye të gjendjes së grave rome në familje, dhe diskriminimi i fëmijëve romë në sistemin arsimor.

Pjesëtarët e komunitetit etnik rom

Romët në Maqedoni janë komuniteti më i cenueshëm etnik, i cili jeton në margjinat e shoqërisë në kushte substandarde dhe i cili po përballen me të drejtat dhe liritë e rënuara të të drejtave të njeriut në të gjitha fushat e veprimit shoqëror. Pjesëtarët e komunitetit etnik rom po përballen me një gjendje të vështirë socio-ekonomike dhe mungesë të dokumenteve të identifikimit personal, probleme shëndetësore, akses të kufizuar në arsim dhe punësim, diskriminim, mungesë të kushteve të banimit, etj. E gjitha kjo kontribuon për mungesë të aksesit në jetë dinjitoze. Me regjistrimin e fundit të popullsisë, të zbatuar në vitin 2002, 53.879 persona janë identifikuar si romë në Maqedoni.³⁶

Akoma ekziston diskriminimi sistemik ndaj romëve, sidomos në sjelljen e zyrtarëve të policisë ndaj romëve në kalimet kufitare, në paaksesueshmërinë e grave rome në mbrojtje shëndetësore dhe shërbime gjinekologjike, dhe segregimi i fëmijëve romë.

Shkalla e papunësisë së romëve për momentin është më se 70%, që është më se dyfishi i papunësisë me të cilin po përballen jo-romët. Kjo mungesë e aksesit në tregun e punës, poashtu rezulton për faktin se romët po përballen me një shkallë shumë më të lartë të varfërisë, në raport me jo-romët. Të dhënat tregojnë se shumica e romëve jetojnë në lagje të përqëndruara në zonat më të varfëra ose në zonat periferike. Romët jetojnë në kushte të vështira jetese, me një infrastrukturë shumë të keqe dhe të ndërzhvilluar. Rreth 28% të popullsisë rome jeton në vendbanime të improvizuara, në lagje të varfëra me ndërtime të paligjshme në kushte të varfërisë së skajshme, substandarde, familje të mëdha dhe me më shumë njerëz në një dhomë. Rreth 50% të vendbanimeve rome nuk kanë kushte sanitare, ndërsa rreth 61% nuk kanë tualet ose banjë në brendinë e shtëpisë.³⁷

Romët po përballen me diskriminim dhe stigmë në shumë nivele, duke përfshirë dhe përfaqësimin e kufizuar në institucionet dhe akses të kufizuar në drejtësi. Gjendja vetëmse po ndërlikohet me politikat të cilat parandalojnë romët ta braktisin Maqedoninë, si dhe me mbrojtjen e pamjaftueshme të të kthyerve romë nga vendet e Evropës Perëndimore.

Është e domosdoshme të vërehet dhe gjendja e vështirë dhe shqetësuese e grave rome, të cilat shpesh përballen me diskriminim të shumëfishtë – në bazë të gjinisë dhe origjinës etnike – si dhe me shkelje tjera të të drejtave të njeriut, për arsye të pozitës që kanë gratë rome në familje, dhe diskriminimi i fëmijëve romë në sistemin arsimor.

36 Popullsia, Enti i Statistikave, e disponueshme në: <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/PDFGodisnik2013/03-Naselenie-Population.pdf>

37 Burimi: UNDP <https://goo.gl/BcOuQQ>

Fëmijët

Konventa për të Drejtat e Fëmijës përkufizon fëmijën si qenie njerëzore e cila nuk ka arritur moshën 18 vjeç të jetës. Konventa poashtu përcakton të drejtat e patjetërsueshme të qytetarëve më të rinj të shteteve në botë, siç është e drejta e jetës dhe shëndetit, mbijetesës dhe zhvillimit, mbrojtjes, arsimit dhe mundësive të barabarta, pavarësisht nga gjinia, gjuha, përkatësia fetare, sociale, ose çfarëdo përkatësie tjetër. Njëjtë si të rriturit, ashtu dhe fëmijët gëzojnë të drejtën e patjetërsueshme të dinjitetit njerëzor, të lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe konfesionit fetar dhe të drejtën e ruajtjes së identitetit vetjak.

Në Republikën e Maqedonisë, një pjesë e madhe, pikërisht 28,6% nga gjithë njerëzit e varfër në Maqedoni janë fëmijë. Fëmijët janë në rrezik më të lart nga varfëria sesa personat e rritur ose më të moshuar. Varfëria e fëmijëve është e lidhur ngushtë me të drejtat themelore.³⁸

Kategoritë më të cënueshme të fëmijëve janë fëmijët nga familjet socialisht të rrezikuara, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët nga zonat rurale dhe fëmijët pjesëtarë të komuniteteve të caktuara etnike.

Fëmijët e cënueshëm, sidomos fëmijët e varfër dhe të marginalizuar, të cilët më së shpeshti vijnë nga pakicat etnike dhe nga amvisëri me burime të kufizuara, më tepër janë të nënshtrueshëm ndaj rrezikut e probabilitetit të jenë pamjaftueshëm të strehuar, të përjashtuar nga arsimi, të diskriminuar ose të eksploatuar.

Fëmijët në rrugë zakonisht paraqesin kategorinë më të rrezikuar të fëmijëve në kuadër të kombit, të cilët janë të detyruar të lypin, si burim ky kryesor i të ardhurave. Përveç se nuk kanë akses në arsim, në mbrojtje shëndetësore dhe përfaqësim përkatës juridik, këto fëmijë i janë nënshtruar rrezikut që të jenë të socializuar në mënyrë jopërkatëse, gjë kjo e cila vështirëson integrimin e tyre në shoqëri më vonë në jetë.

Fëmijët me aftësi të kufizuara fizike ose intelektuale në Republikën e Maqedonisë po përballen me mangësi në shërbimet arsimore, sociale dhe shëndetësore. Ata po vazhdojnë të jenë të diskriminuar në të gjitha segmentet e jetesës shoqërore.

Gratë

Diskriminimi gjinor dhe marginalizimi i grave, si dhe perceptimi i vjetëruar se gratë takojnë ekskluzivisht në amvisëri është i pranishëm në Maqedoni edhe në ditët tona. Jobarazia e grave dhe burrave, gjegjësisht, distribuimi i jobarabartë i të drejtave, burimeve dhe fuqisë midis burrave dhe grave është evident nga të dhënat e shumta statistikore.³⁹ Gratë akoma po përballen me jobarazi në kuptimin e mundësive të punësimit, të marrjes së rrogës, të aksesit në të drejtën e shëndetit dhe realizimit të tij, në të drejtën e martesës dhe familjes, etj. Për momentin, më pak se 40% të vendeve të punës janë zënë nga gra, edhe pse gratë përbëjnë rreth 50,01% nga popullsia e përgjithshme.⁴⁰

Nevojitet implementimi i standardeve për të mundësuar dhe fuqizuar gratë dhe për të mbrojtur ato nga diskriminimi, aksesin e barabartë në punë për rrogë të njëjtë, arsimin, mbrojtjen shëndetësore, pjesëmarrjen e tyre politike, duke përfshirë këtu dhe gratë nga rajonet rurale, statusin e barabartë juridik në kuptimin e trashëgimisë dhe pronës, shëndetin seksual dhe riprodhues dhe të drejtat.

Jobarazitë në ndarjen e fuqisë midis burrave dhe grave rezultojnë me pozitën e inferioritetit dhe rrezikut në jetën e gruas. Duke marrë parasysh të dhënat mbi numrin e grave viktime të dhunës në familje në Republikën e Maqedonisë, më së shpeshti dhuna në familje identifikohet me dhunë mbi gruan, madje dhunë psikike, fizike, seksuale dhe materiale.

Të dhënat tregojnë se dhuna në familje ka tipare të theksuara të dhunës në bazë të gjinisë. Sipas të dhënave statistikore, 93% të kryerësve të denoncuar dhe të dënuar të veprave penale në kryerjen e dhunës në familje në periudhën e hulumtimit janë burra, ndërsa 82% të viktimave janë gra.⁴¹ Në lidhje me reagimin e institucioneve në rastet e dhunës në familje, mungojnë praktikrat unike gjatë trajtimit të viktimave nëpër të gjitha institucionet relevante në tërë territorin e shtetit. Sipas të dhënave të disponueshme, në vend ekzistojnë katër qendra shtetërore të strehimit për viktimat e dhunës në familje, që sigurojnë strehim deri në gjashtë muaj.

38 Pasqyra e varfërisë së fëmijëve në Maqedoni, UNICEF, e disponueshme në: <https://www.unicef.org/ceecis/Child-Poverty-Study-OVERVIEW-ENG.pdf>

39 Gratë dhe burrat në Republikën e Maqedonisë, publikim i Entit të Statistikave të RM, i disponueshëm në: <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/Gender2017.pdf>

40 Sondazhi i krahut të punës, Enti i Statistikave të RM, i disponueshëm në: <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.18.03.pdf>

41 Mirčeva S., Čačeva V., Kenig N. Zëri i drejtësisë: Raport Hulumtues: Vlerësimi i procedurave gjyqësore për rastet e dhunës në familje, me theks të posaçëm në menaxhimin e lëndëve nga pikëpamja e gjinisë, Universiteti Kiril dhe Metodi, Instituti i Hulumtimeve Sociologjike dhe Politiko-Juridike, Shkup, 2014.

Personat me aftësi të kufizuara

Ky grup përfshin kategori të ndryshme të personave me aftësi të kufizuara fizike dhe intelektuale. Konventa për Personat me Aftësi të Kufizuara përcakton se diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar do të thotë bërjen e çdo dallimi, përjashtimi ose kufizimi në bazë të aftësisë së kufizuar, me qëllim ndikimi mbi çrregullimin ose revokimin e njohjes, ushtrimit ose realizimit, në bazë të barabartë me të tjerët, të të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në fushën politike, ekonomike, sociale, kulturore, civile dhe në çdo fushë tjetër. Këtu janë përfshirë të gjitha format e diskriminimit, si dhe mohimi i përshtatjes së arsyeshme.⁴²

Në Republikën e Maqedonisë, personat me aftësi të kufizuar po përballen me padrejtësi dhe trajtim jo të barabartë në çdo fushë socio-ekonomike. Në qendrat e mbrojtjes sociale janë regjistruar 28.590 persona me aftësi të kufizuar, nga të cilët 4.235 janë fëmijë⁴³. Ata nuk kanë fare, ose kanë akses të kufizuar në mallra dhe shërbime, në arsim, punësim dhe mbrojtje shëndetësore, ndërsa të drejtat e tyre shkelen nga institucionet publike, si dhe nga persona privatë. Ekziston nevoja e madhe që t'u mundësohet personave me aftësi të kufizuar akses në shërbime, si dhe në informacione se si t'i realizojnë të drejtat dhe liritë e tyre.

Kuadri ligjor përcakton standardet e aksesueshmërisë së godinave të reja dhe strukturave publike, të cilat duhej të viheshin në dispozicionin e personave me aftësi të kufizuara deri në fund të vitit 2015. Megjithatë, shumë godina publike mbeten të jenë të paaksesueshme për personat me aftësi të kufizuar fizike. Poashtu, edhe pse të gjitha autobusët që Qeveria kishte blerë për Shkupin që nga viti 2013, ishin të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuar trupore, transporti publik në masë të madhe mbeti i paaksesueshëm në rajonet tjera.⁴⁴

Krijimi i mundësive të barabarta në punësimin e personave me aftësi të kufizuara, integrimi i tyre në shoqëri dhe pjesëmarrja në sjelljen e vendimeve - të gjitha masat e barazisë dhe mosdiskriminimit të personave me aftësi të kufizuar domosdo të shoqërohen me mbështetje financiare në nivelin shtetëror dhe lokal dhe të kryhen në bashkëpunim me shoqatat e qytetarëve dhe me vepruesit tjerë në shoqëri.

Popullsia LGBTI

Personat LGBTI në Maqedoni janë shënjestër e shpeshtë e gjuhës së urrejtjes, krimeve të urrejtjes, bulizmit dhe diskriminimit. Homoseksualiteti është dekriminalizuar në vitin 1996. Edhe pse njerëzit dhe aktivistët u sulmuan disa herë radhazi në vitet e fundit, asnjë nga sulmet nuk u dënua publikisht, e poashtu sulmuesit nuk u gjetën e as nuk u dënuan. Kjo tregon mungesën e hetimit efektiv dhe proaktivitetit të Prokurorisë Publike në mbrojtjen e personave LGBTI. Në lidhje me këtë, diskriminimi, orientimi seksual dhe identiteti gjinor nuk janë integruar në mënyrë të prerë në Ligjin e Mbrojtjes nga Diskriminimi. Është në rrjedhë e sipër procedura e adoptimit të Ligjit të ri të Mbrojtjes nga Diskriminimi, me të cilin janë përfshirë orientimi seksual dhe identiteti gjinor, si baza të posaçme.

Gjatë vitit 2017, disa organizata që punojnë në çështje LGBTI, së bashku me deputetë që paraprakisht kanë kumtuar mbështetjen e tyre për komunitetin LGBTI, morën pjesë në formimin e një Grupi Parlamentar Ndërpartiak për Avancimin e të Drejtave të Personave LGBTI.

Sipas legjislacionit ekzistues, marrëdhënia seksuale me vullnet të lirë midis personave të rritur të të njëjtës gjini nuk është kriminalizuar. Partnerët e gjinisë së njëjtë nuk kanë të drejtën të lidhin martesë ose partneritet. Ligji i Familjes rregullon birësimin e fëmijëve dhe sipas këtij ligji, çdo qytetar në vend mund të birësojë një fëmijë, pavarësisht nga statusi i tij martesor, orientimi seksual ose identiteti gjinor. Deri më tani nuk kemi regjistruar ndonjë rast të përpjekjes për birësim, që të jemi në mundësi ta testojmë këtë Nen.

Pjesëtarët e komunitetit LGBTI në Republikën e Maqedonisë përballen me diskriminim të përditshëm në të gjitha fushat e shoqërisë dhe sipas të dhënave të një hulumtimi, personat LGBTI vuajnë dyfish më tepër diskriminim se personat që nuk i takojnë këtij komunitet⁴⁵. Sa i përket punësimit, Ligji i Marrëdhënieve të Punës, me nenin e tij 6, ndalon diskriminimin e aksesit në punësim që ka të bëjë me "orientimin gjinor". Vetë termi "orientim gjinor" është i kufizuar dhe nuk përfshin të gjitha aspektet e orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Në Nenin 7 të po të njëjtit ligj, ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i punonjësve dhe

42 Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD), e disponueshme në: <https://www.un.org/development/desa/disabilities/convention-on-the-rights-of-persons-with-disabilities.html>

43 Enti Shtetëror i Statistikave, Mbrojtja Sociale e Fëmijëve, të Miturve dhe të Riturve, 2015, e disponueshme në: <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/2.4.16.12.pdf>

44 Raporti mbi të Drejtat e Njeriut në Maqedoni për vitin 2017, i disponueshëm në: <https://www.state.gov/documents/organization/277435.pdf>

45 Diskriminimi, dhuna dhe keqtrajtimi në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor: Raport Hulumtues

kandidatëve për punësim në lidhje me kushtet e punës, ngritjes në detyrë, aksesit në të gjitha llojet dhe shkallët e aftësimin profesional.

Sipas analizës së nevojave dhe problemeve të personave LGBTI në Maqedoni, pothuajse 39 përqind të personave LGBTI kanë përjetuar diskriminim në vendin e punës, për shkak të orientimit seksual dhe/ose të identitetit gjinor. ¼ e të anketuarve në këtë analizë mendojnë se nuk janë avancuar për shkak të orientimit të tyre seksual dhe/ose identitetit gjinor, ndërsa ¼ besojnë se janë pushuar nga puna për po të njëjtat shkaqe. Pothuajse 28% besojnë se orientimi seksual dhe/ose identiteti gjinor kanë qenë arsyeja që ata të mos e marrin postin për të cilin kanë aplikuar. Nga 39% të personave LGBTI të cilët kanë përjetuar diskriminim, 90% nuk kanë denoncuar rastet në asnjë situatë e në asnjë organizatë.

Në kuptimin e mbrojtjes sociale, 39% të të anketuarve konsiderojnë se kanë qenë viktima të diskriminimit në procesin e realizimit të të drejtave të veta për mbrojtje sociale. Nga ky numër, 45,28% të të anketuarve nuk kanë denoncuar diskriminimin për shkak të mosbesimit në institucionet.

Në lidhje me shëndetësinë dhe aksesin në shërbimet shëndetësore, ekziston pengesa sidomos ndaj personave transgjinorë, ndërsa procedurat mjekësore që kanë të bëjnë me personat transgjinorë, të cilët janë në proces të tranzicionit, nuk njihen nga Ministria e Shëndetit dhe financiarisht nuk mbulohen nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor. Stafii mjekësor dhe mjekët nuk kanë njohuri të mjaftueshme për punë me këto grupe dhe nuk janë sensibilizuar për të punuar me ata.

Në lidhje me arsimin, të rinjtë LGBTI janë shumë më shpesh viktima të bulizmit në shkollat, krahasuar me moshatarët e tyre heteroseksualë. Poashtu, ata janë pesë herë më shpesh viktima të ngacmimit seksual dhe sulmeve. Hulumtimet tregojnë se depresioni, pikëllimi, mungesa e shpresës dhe idetë për vetëvrasje janë në mesin e rreziqeve më të larta në jetët e të rinjve LGBTI. Librat mësimorë dhe materialet edukative që përdoren në proceset edukative në shkollët e ndryshme të arsimit periodikisht po rishikohen nga organizatat joqeveritare (OJQ) në vend dhe për fat të keq, akoma ekzistojnë përmbajtje që njësijnë homoseksualitetin me sëmundje ose çrregullim. Ministria e Arsimit paralajmëroi rishikimin e të gjithë librave mësimorë në Strategjinë e re Gjithëpërfshirëse të Arsimit 2018-2025, megjithatë dështoi në integrimin e një strategjie kundër bulizmit në edukimin gjithëpërfshirës seksual në programet arsimore, siç u propozua nga organizatat joqeveritare.

Personat e moshuar

Trendi i plakjes së popullsisë në Maqedoni është i dukshëm. Sipas të dhënave të Regjistrimit të Përgjithshëm të Popullsisë të vitit 2002, përqindja e popullsisë së moshuar mbi moshën 60 vjeç, krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë, arrin 15% ose 303.534 persona të moshuar. Nga ata, 163 898 janë gra, ndërsa 139 636 janë burra.⁴⁶

Personat e moshuar çdo vit po përballen me shkeljen e të drejtave të njeriut, duke u nisur nga diskriminimi dhe përjashtimi social dhe politik, e deri në abuzimin në institucionet e kujdesit, neglizhencën në kushtet humanitare dhe mohimin dhe racionalizimin e mbrojtjes shëndetësore.⁴⁷ Ata nuk janë një grup homogjen dhe sfidat me të cilat po përballen në mbrojtjen ose ushtrimin e të drejtave të tyre të njeriut kanë shumë dallime. Përderisa disa po vazhdojnë të shtjellojnë jetë aktive si pjesëtarë të komunitetit të tyre, shumë të tjerë po përballen me mungesën e kujdesit përkatës ose me izolim.

Në Maqedoni, personat e moshuar janë në gjendje më të pafavorshme për shkak të shumës së ulët të pensionit, që i bën ata të mos jenë në gjendje t'i përmbushin nevojat elementare të ekzistencës. Në të gjitha komunat ekziston papunësia, që është arsye për personat e moshuar të jetojnë në familje shumë-gjeneratash, ku pensioni shpesh, edhe pse minimal, paraqet burimin e vetëm të të ardhurave për të gjithë anëtarët e familjes.

Ekzistojnë raste kur personat e moshuar eksploatohen ekonomikisht nga familjarët e tyre të ngushtë, kurse pastaj as nuk mërziten llogari për ta. Në raste të caktuara, është e pranishme dhuna në familje ndaj personave të moshuar. Një problem tjetër me të cilin po përballen personat e moshuar është paaksesueshmëria e shtëpive publike për personat e moshuar. Nga njëra anë, numri i vendeve në këto shtëpi është i kufizuar, dhe në anën tjetër, personat e moshuar nuk janë financiarisht të fuqishëm për ta shfrytëzuar këtë shërbim. Poashtu, familjarët e tyre të afërt nuk janë në mundësi të kontribuojnë për banimin në shtëpi për personat e moshuar.

⁴⁶ Strategjia Kombëtare për Personat e Moshuar 2010 - 2020. E disponueshme në: <http://mtsp.gov.mk/WBStorage/Files/Strategjia%20za%20stari%20lica%20juni.pdf>

⁴⁷ European Commission, Project Cycle Management Guidelines, 2004 p. 143

Kapitulli 5:

Qasja e bazuar në të drejtat
e njeriut dhe cikli i projektit



Hartimi dhe zbatimi i projekteve duke respektuar parimet e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut

Organizatave të shoqërisë civile mund të punojnë në mënyra të ndryshme, megjithatë, pjesa më e madhe e tyre organizojnë punën e vet në kuadër të projekteve të kufizuara me kohë ose me sigurimin e shërbimeve në kuadër të programeve që kohë pas kohe po rishikohen dhe po avancohen. Disa poashtu zbatojnë fushata dhe aktivitete monitorimi (watchdog) dhe këto aktivitete zakonisht janë disenjuar në kuadrin e ndonjë sistemi të caktuar. Kështu pra, pavarësisht nga ajo se për çfarë lloji të organizatës së shoqërisë civile bëhet fjalë ose nga ajo se cila mënyrë e punës po aplikohet, më së shpeshti koncepti i “projektit” përdoret për orientimin dhe disenjimin e aktiviteteve, intervenimeve dhe shërbimeve. Prandaj, dhe duke u nisur nga nevoja për demonstrimin se si QBDNJ mund të përdoret në praktikë nga organizatat e shoqërisë civile, është e dobishme të demonstronhet se si QBDNJ po integrohet në kuadrin e ciklit të projektit.

Projekti paraqet një sërë aktiviteteve, të cilat bashkërisht janë orientuar drejt arritjes së një objekti të vendosur qartazi në kuadrin e kohës së përcaktuar paraprakisht, me buxhetin e përcaktuar paraprakisht.⁴⁸ CTë gjithë projektet po zbatohen në kuadrin e një cikli të projektit. Cikli i projektit ndjek rrjedhën e projektit që nga idea fillestare, nëpërmjet zbatimit të saj e deri në pjesën e vlerësimit. Cikli i projektit vendos strukturën e cila siguron se të gjitha palët e interesuara janë konsultuar, dhe duhet përcaktuar: vendimet kryesore që duhet të sillen, informacionet e nevojitura që duhet të mblidhen dhe përgjigjet në çdo fazë individuale të projektit. Ai bazohet mbi vlerësimin e përvojës së mëhershme gjatë planifikimit të programeve dhe projekteve të ardhshme⁴⁹.

Cikli i projektit përbëhet nga katër hapa bazë⁵⁰:



Qasja e bazuar në të drejtat e njeriut që pritet nga cikli i projektit është:

1. Integrimi i punës së përditshme në parimet bazë të të drejtave të njeriut, të numëruara dhe të përshkruara në kapitujt e mësipërm të këtij Manuali
2. Sigurimi sistemik i fokusit të sensibilitetit kulturor dhe barazisë gjinore në çdo hap të ciklit të projektit

48 European Commission, Project Cycle Management Guidelines, 2004 fq. 143

49 Ibid.


50 UNDP. A Human Rights-Based Approach Toolkit (+). 2009

Aplikimi i QBDNJ në ciklin e projektit nuk paraqet një mënyrë krejtësisht e re të hartimit dhe zbatimit të projekteve. Vetëm se, nevojitet që në mënyrë sistematike dhe të ndërgjegjshme të bëhet kujdes për të drejtat e njeriut gjatë të gjithë aspekteve të zbatimit të ciklit të projektit⁵¹.

Duke bërë krahasimin midis një projekti që nuk është bazuar në QBDNJ, me një projekt që është bazuar në QBDNJ, mund t'i identifikojmë dallimet praktike të cilat organizatat e shoqërisë civile duhet t'i adresojnë:

Projekti i krijuar me QMD	Projekti i krijuar pa QMD
Grupi qëllimor është identifikuar si aktor dhe agjent aktiv i ndryshimit (bartësit e të drejtave dhe bartësit e detyrave)	Grupi qëllimor identifikohet si një grup pasiv, i cili "pranon ndihmë" (shfrytëzuesit)
Pjesëmarrja është e domosdoshme për arritjen e zëshmërisë në proces	Pjesëmarrja e kufizuar
Pjesëmarrësit janë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre, dhe si të kërkojnë përmbushjen e tyre, si dhe si t'i përmbushin obligimet dhe detyrimet ndaj bartësve të të drejtave	Të drejtat nuk diskutohen drejtpërsëdrejti dhe haptazi
Fokusi është në të drejtat e shkelura, të papërmbushura	Fokusi është në nevojat
Procesi është njëjtë i rëndësishëm si dhe vetë rezultati	Shumë shpesh rezultatet janë më të rëndësishme se vetë procesi

Planifikimi dhe zbatimi i programeve dhe projekteve me aplikimin e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut kërkon integrimin e parimeve të saj bazë në të gjitha fazat e ciklit të projektit.



51 UNFPA A Human Rights – Based Approach to Programming – Practical Implementation Manual and Training Materials, 2014. P.93.

Hapi 1: Analiza e gjendjes

Në këtë fazë identifikohet problemi i cili duhet të adresohet me projektin

Analiza e gjendjes (e njohur edhe si analiza e problemit në fazën e identifikimit të ciklit të projektit) është hapi i parë nga disa hapat në një cikël të zakonshëm të projektit. Ajo paraqet familjarizimin me gjendjen aktuale dhe me rrethanat relevante në fushën/temën e interesit (p.sh. mbrojtja e të drejtave nga mbrojtja sociale e personave me aftësi të kufizuara ose mbrojtja e mjedisit jetësor në Rajonin e Pellagonisë). Planifikimi i projektit fillon me identifikimin e qartë dhe të përpiktë të problemit i cili duhet të adresohet nga pikëpamja e të drejtave të njeriut dhe e arsyeve për të. Në këtë fazë qartësohet se **kush është prekur me problemin** dhe serioziteti i gjendjes së të prekurve.

Në këtë fazë zbatohet dhe një analizë e gjerë e shkaqeve shoqërore, institucionale dhe politike të problemit, pastaj e normave shoqërore, kapaciteteve institucionale në të gjitha nivelet e pushtetit, të mekanizmave në dispozicion për kërkimin e përgjegjësive, si dhe të kuadrit juridik të problemit. Të gjithë këta faktorë mund të ndikojnë si pozitivisht, ashtu dhe negativisht mbi realizimin e të drejtave të grupeve të cënueshme. Andaj, është me rëndësi që ato të identifikohen qartë.

Analiza e gjendjes po zbatohet me dhënien e përgjigjes në pyetjet në vijim⁵²:

- Ç'po ndodh dhe kujt po i ndodh?
- Përse po ndodh?
- Kush janë subjektet kryesore që shkaktojnë ose janë të prekur nga problemi?
 - Kush janë poseduesit e mundshëm të të drejtave?
 - Kush janë bartësit e mundshëm të detyrave?
- Përse poseduesit e të drejtave nuk janë në mundësi t'i realizojnë të drejtat e veta?
- Përse bartësit e detyrave nuk përmbushin obligimet e veta ndaj poseduesve të të drejtave?
- A ekziston kuadri ligjor relevant me të cilin rregullohet kjo çështje?

Analiza e gjendjes zhvillohet përmes:

- Këshillimeve me palët e interesuara relevante
- Hulumtimeve të raporteve, të të dhënave statistikore në dispozicion
- Analizën e ligjeve dhe rregullave tjera, duke përfshirë këtu edhe instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut

Në kuadër të analizës së gjendjes, përdoren edhe mjetet e mëposhtme:

- Analiza e kauzalitetit
- Analiza e të drejtave dhe detyrimeve të supozuara
- Analiza e mangësive të kapacitetit

52 UNDP. A Human Rights-Based Approach Toolkit (+). 2009


Analiza e kauzalitetit (Causality analysis)

Ky mjet mundëson njohjen dhe identifikimin e manifestimeve të problemit, pasojat e tij dhe shkaqet e tij të menjëhershme, elementare dhe strukturore. Qëllimi i analizës së kauzalitetit është identifikimi i shkaqeve të ndryshme, për të cilat një e drejtë e caktuar e njeriut është e perealizueshme, ose realizimi i së cilës është vështirësuar. Në këtë fazë identifikohen edhe poseduesit (akoma të mundshëm) të të drejtave dhe bartësit e detyrave.

Analiza e kauzalitetit mundëson identifikimin e pasojave të ndonjë problemi të caktuar si dhe shkaqet e menjëhershme, elementare dhe strukturore për ekzistimin e problemit. Është me rëndësi të identifikohet si duhet kauzaliteti i ndërsjellë i shkaqeve që krijojnë problemin. Prandaj, këto shkaqe duhet të grupohen në tre nivele:⁵³

- **Shkaqet e menjëhershme** janë shkaqet që drejtpërsëdrejti bëjnë që problemi të ekzistojë (p.sh. mosveprimi i autoriteteve lokale në mënjanimin e deponisë së paligjshme e cila gjendet përreth një lagjeje në të cilën jetojnë pjesëtarë të komunitetit etnik rom)
- **Shkaqet elementare** janë pasojë e politikave, ligjeve dhe disponueshmërisë së burimeve (p.sh. mosveprimi i autoriteteve lokale i përshkruar më herët është pasojë e një rregulle të paqartë për atë se kush krijon kolizionin e kompetencave midis pushtetit lokal dhe Ministrisë së Mjedisit Jetësor)
- **Shkaqet strukturore/sistemike** kanë të bëjnë me kushtet për zgjedhjen e të cilave nevojiten intervenime në afat të gjatë dhe ngërthejnë qëndrime të rrënjësura, paragjykime dhe sjellje të caktuara (p.sh. paragjykimet dhe stereotipet e rrënjësura që moti ndaj pjesëtarëve të komunitetit etnik rom ndikojnë në reagimin e organeve shtetërore kur duhet të ndërmerren ndonjë veprim me të cilin zgjidhjet ai problem, i cili prek pjesëtarë të këtij grupi etnik).

Analiza fillon me manifestimin elementar të problemit dhe vazhdon me identifikimin e shkaqeve të problemit. Vizualisht, analiza zbatohet me të ashtuquajturën pemë/piramidë të problemeve.



Gjatë zbatimit të analizës së kauzalitetit, është me rëndësi të ekzistojë vetëdija në mesin e personave të drejtat e të cilëve janë prekur nga problemi. Nëse nuk ekziston vetëdija, së pari duhet zbatuar aktivitete për ndërgjegjësimin, e pasi të bëhet kjo, të kalohet në marrjen e aktiviteteve tjera.

Përvoja tregon se përderisa shkaqet e menjëhershme të problemit mund të dallojnë, shkaqet elementare janë pothuajse çdoherë të njëjta; për shembull, mungesa e kapacitetit midis bartësve të detyrave (prindërit, nëpunësit publikë, bartësit e funksioneve), diskriminimi gjinor, ligjet jopërkatëse, gjendja e dobët ekonomike, etj. Adresimi i shkaqeve elementare për cilindo problem me siguri se do të krijojë një ambient që mundëson zgjidhjen e shumë problemeve tjera, fuqizimin e qëndrueshmërisë së projektit. Megjithatë, në të njëjtën kohë duhet marrë parasysh se shkaqet elementare janë më të vështirat për t'i adresuar.

53 UNFPA A Human Rights – Based Approach to Programing – Practical Implementation Manual and Training Materials, 2014. P.97


Analiza e të drejtave dhe detyrimeve të supozuara (Role pattern analysis)

Me këtë mjet identifikohen bartësit e detyrave dhe rolet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me problemin i cili duhet të adresohet. Kjo analizë po zhvillohet në bazë të gjetjeve të analizës së kauzalitetit dhe jep përgjigjen e dy pyetjeve të mëposhtme:

- Kush janë poseduesit e të drejtave
- Kush janë bartësit e detyrave dhe cilat përgjegjësi pritet të përmbushen nga ata
- Cila/si është lidhja midis poseduesve të të drejtave dhe bartësve të detyrave

Në këtë fazë, duhet të merret parasysh se një grup mund t'i ketë rolet e **poseduesit të të drejtave** dhe **bartësit të detyrave** në të njëjtën kohë. Për shembull, fëmijët kanë të drejtën të kërkojnë nga prindërit e tyre të vizitojnë mësimet në shkollë rregullisht (e drejta e arsimit). Prindërit në këtë rast mund t'i identifikojmë si **bartës të detyrave** në nivel të amvisërisë. Në nivel të komunitetit, **bartës të detyrave** do të ishin: mësimdhënësit. Në nivel të pushtetit lokal – komunat, dhe në nivel të pushtetit qendror – Ministria e Arsimit dhe shteti si bartës themelor i detyrave, duke patur parasysh obligimet që ka ndërmarrë me aderimin në marrëveshjet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Është me rëndësi të theksohet se çdo marrëdhënie “e drejtë-detyrë” patjetër duhet të ekzistojë si e drejtë në ndonjë marrëveshje të caktuar ndërkombëtare, të ratifikuar nga shteti.

Pasi të identifikohen bartësit e detyrave, është me rëndësi të identifikohen dhe numërohen detyrat e tyre në lidhje me problemin që prek **poseduesit e të drejtave**. Obligimet janë përfshirë me marrëveshjet ndërkombëtare, Kushtetutën dhe ligjet.



Analiza e mangësive të kapacitetit (Capacity Gap Analysis)

Me analizën e kapacitetit, i jepet përgjigje pyetjes se përse ndonjë e drejtë e caktuar nuk është realizuar. Analiza bazohet mbi supozimin *se poseduesit e të drejtave* nuk mund t'i realizojnë të drejtat e veta për shkak të mungesës tek *bartësit e detyrave* për t'i mbrojtur të drejtat.

Ç'është kapaciteti?

Aftësia që me efektshmëri të realizohen funksionet e vendosjes dhe arritjes së objektivave dhe identifikimi dhe zgjidhja e problemeve. Kapaciteti paraqet përmbledhjen e të gjithë faktorëve që mundësojnë që personat, komunitetet, institucionet, organizatat dhe qeveritë t'i kryejnë rolet dhe përgjegjësitë e veta në mënyrë përkatëse.⁵⁴

Qëllimi i analizës së mungesës së kapacitetit është t'i identifikojë pengesat që pengojnë poseduesit e të drejtave të kërkojnë realizimin e të drejtave, si dhe mungesës së kapacitetit të bartësve të detyrave për t'i përmbushur obligimet e veta. Me rregull, analiza duhet të bëhet duke marrë parasysh kategoritë e ndryshme të kapacitetit, siç janë: përgjegjësia, autoriteti/fuqia, burimet, etj.

Rezultati i analizës është lista e mungesave të kapaciteteve dhe të poseduesve të të drejtave dhe të bartësve të detyrave për sa iu përket shkaqeve dhe të drejtave të prekura me problemin. Individët si bartës të së drejtës duhet të merren në përgjegjësi. Kapaciteti i përkufizuar në mënyrë të përgjithshme ngërthen pesë komponente:

- **Përgjegjësia/motivimi/përkushtimi/lidershipi** ka të bëjë me pranimin personal të personit se ai/ajo duhet të ndërmarrë diçka për ndonjë problem të posaçëm. Kjo përfshin pranimin e obligimit dhe është detyruar me norma juridike dhe morale.
- **Autoriteti është i lidhur me legjitimitetin e ndonjë veprimi të caktuar**; kur një individ ose një grup dijnë se mund të ndërmarrin ndonjë veprim të caktuar/gjegjësisht se veprimi i tillë është i lejuar. Ligjet, rregullat e shkruara dhe ato të pashkruara, tradita dhe kultura përcaktojnë se çka është, e çka nuk është e lejueshme në një shoqëri të caktuar. Raportet e fuqisë pasqyrojnë strukturën e autoritetit në shoqërinë e dhënë.
- **Akcesi në dhe kontrolli i burimeve**. Nëse ndonjë person i caktuar pranon se duhet të ndërmerret diçka në lidhje me ndonjë problem të caktuar, ajo vetëvetiu nuk mjafton në qoftë se personi nuk posedon burime. Prandaj, kapaciteti do të thotë se një person i caktuar është në mundësi të veprjë dhe ka fuqinë e të vepruarit. Burimet mund të grupohen si: burime njerëzore, burime materiale dhe burime organizative.
- **Aftësia e sjelljes racionale të vendimeve dhe të mësimi** – Sjellja racionale e vendimeve kërkon analizën e bazuar në prova dhe analizën logjike për shkaqet e problemit. Duhet të ndërmerren aktivitete në bazë të vendimeve të bazuara në analizë. Pas zbatimit të aktivitetit, rivlerësimi i rezultatit dhe i ndikimit do të çojë drejt një analize të përmirësuar në veprimin e radhës.
- **Aftësia e komunikimit**. Aftësia për të komunikuar dhe për të patur akses në informacione dhe sisteme komunikimi është elementare që personat dhe grupet të kërkojnë realizimin e të drejtave të veta, përkatësisht, përmbushjen e detyrimeve të tyre. Komunikimi është i rëndësishëm për "lidhjen" e aktorëve të ndryshëm kryesorë në indin shoqëror në rrjete funksionale të afta për të adresuar probleme të caktuara.

Marrëdhënia midis *poseduesve të të drejtave dhe bartësve të detyrave* formon një model që bashkon personat dhe komunitetet mes vete dhe më tej me nivelet më të larta të vendimmarrjes në shoqëri. Identifikimi i bartësve të detyrave dhe përcaktimi i shtrirjes së përgjegjësisë së tyre janë me rëndësi të menjëhershme për zbatimin e mirë të QBDNJ në procesin e përgatitjes së projekteve. Pakësimi i mungesave të kapaciteteve të bartësve të detyrave paralelisht me rritjen e kapaciteteve të poseduesve të të drejtave, duhet qenë në qendrën e procesit të planifikimit.

54 UNFPA A Human Rights – Based Approach to Programing – Practical Implementation Manual and Training Materials, 2014. P.101

Hapi 2: Planifikimi dhe disenjimi i projektit

Në këtë hap gjenden zgjidhjet e problemeve të identifikuar në Hapin 1

- Planifikimi i projekteve dhe QBDNJ

Një pjesë e rëndësishme e proceseve të planifikimit dhe formulimit të projekteve është përzgjedhja e strategjisë për mënyrën se si adresohet ndonjë problem i caktuar. Kjo përzgjedhje duhet të bazohet në provat e mbledhura gjatë fazës së analizës. Qëllim i këtij hapi është të identifikohen aktivitete të mundshme për të cilat ka gjasa se do të kontribuojnë për zvogëlimin e dallimit në kapacitetin midis poseduesve të të drejtave dhe bartësve të detyrave. Aktivitetet e tilla duhet të orientohen drejt rritjes së përgjegjësisë, autoritetit, burimeve dhe proceseve të sjelljes së vendimeve dhe aftësive të komunikimit të poseduesve të të drejtave dhe bartësve të detyrave, duke marrë parasysh shkaqet elementare/strukturore të problemit të identifikuar. Kjo përfshin përmbledhjen e gjetjeve nga hapat e mëhershëm:

- Cilat janë shkaqet elementare të problemit i cili duhet të adresohet
- Kush dhe të drejtat e kujt janë shkelur
- Kush janë bartësit kryesorë të detyrave, të cilët kanë përgjegjësinë e sigurimit, respektimit, mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave në fjalë
- Sa është kapaciteti i tyre për t'i realizuar detyrimet e veta.

Hapi i radhës është të kalohet nga analizimi i asaj që mungon, drejt asaj me të cilën projekti mund të kontribuojë për zgjidhjen e problemit, shkaqet e tij dhe mungesat e identifikuar të kapacitetit. Këtu është me rëndësi të identifikohen mundësitë se si më së miri do të adresohen mungesat e kapaciteteve. Janë këto vendime strategjike, të cilat do të influencojnë rezultatit dhe prituri të projektit, në afat të shkurtër ose të gjatë. Në këtë hap ndiqen udhëzimet e donatorit potencial.

- Cilat persona do të përfshihen me planifikimin/disenjimin e projektit?
- Cilat janë gjetjet dhe rekomandimet e organeve ndërkombëtare për vëzhgimin e të drejtave të njeriut në lidhje me problemin e identifikuar?
- Çka mund të bëhet për të pakësuar ose mbyllur mungesat e kapaciteteve të poseduesve të të drejtave në realizimin e të drejtave të veta dhe të bartësve të detyrave në përmbushjen e obligimeve të veta.

- QBDNJ dhe vargu i rezultateve (Result chain)

Rezultatet e aktiviteteve të zbatuara në nivele të ndryshme formojnë të ashtuquajturin varg të rezultateve (Result chain). Gjatë formulimit të rezultateve në çdo nivel, është me rëndësi të merren parasysh implikimet e mundshme të QBDNJ.



Depozita/Input – Mjetet financiare, njerëzore dhe materiale që do të përdoren për projektin⁵⁵. Nga pikëpamja e QBDNJ, është me rëndësi të sigurohen garanca se këto resurse mjaftojnë për të aksesuar komunitetet më të margjinalizuara, si dhe se të gjitha burimet njerëzore dhe materiale janë sensitive për nga gjinia dhe kultura.

Produkti/Output – Produktet ose shërbimet që dalin nga zbatimi i aktiviteteve në kuadër të projektit. Produktet duhet qenë të matshme, të prekshme dhe realisht të arritshme⁵⁶.

55 OECD/DAC, Glossary of Key Terms in Evaluation and Results-Based Management, 2002. Available at: http://www.oecd.org/document/21/0,3343,en_2649_34435_40381973_1_1_1_1,00.html.

56 UNDG, Draft Technical Brief, p. 1. Available at: www.undg.org/docs/9871/Technical-brief---Outcomes-v2.0-Oct07.doc.

Produkti i cili përmbush kriteret e QBDNJ është një produkt ose shërbim i cili në mënyrë të veçantë kontribuon për mbylljen ose pakësimin e mungesave të kapaciteteve të:

1. Poseduesve të të drejtave për t'i realizuar dhe mbrojtur të drejtat e veta dhe/ose *bartësve të detyrave* për t'i përmbushur obligimet e veta përkatëse, dhe
2. Kornizave juridike dhe institucionale, si dhe të politikave, me qëllim krijimi i ambientit përkatës për poseduesit e të drejtave dhe *bartësit e detyrave* për t'i përmbushur obligimet e veta.

Rezultati/Outcome – Efektet e dëshiruara ose të arritura afatshkurtëra ose afatmesme të produkteve të realizuara, për realizimin e të cilave zakonisht nevojiten përpjekjet e përbashkëta të më shumë partnerëve⁵⁷. Rezultati i cili përmbush kriteret e QBDNJ do të ishte fuqizimi i kapaciteteve të *poseduesve të të drejtave* dhe *bartësve të detyrave*, si dhe ndryshimet pozitive në zbatimin e normave, politikave, dhe përmirësimi i kornizës institucionale për realizimin e të drejtave.

Ndikimi/Impact – Në kuadrin e QBDNJ, ndikimi do të thotë se qëllimet zhvillimore janë arritur dhe të drejtat janë realizuar, që nënkupton përmirësim të konsiderueshëm të realizimit të të drejtave dhe të përmbushjes së detyrimeve. Realizimi i ndikimit është çdoherë një proces afatgjatë.

Hapi 3: Zbatimi

Është kjo faza kur zbatohen aktivitetet e përcaktuara në Hapin 2.

Zbatimi është faza kur gjithçka që është planifikuar në fazën e mëhershme vihet në veprim. Zbatimi i projekteve me aplikimin e QBDNJ dallohet nga zbatimi i projekteve pa QBDNJ, në tre mënyra:

1. Në zbatimin e projekteve me të cilat aplikohet QBDNJ, detyrimisht janë përfshirë edhe *poseduesit e të drejtave* edhe *bartësit e detyrave*.
2. Strategjia e zbatimit të projekteve është fokusuar në fuqizimin e *poseduesve të të drejtave* dhe në ngritjen e kapaciteteve të *bartësve të detyrave* për t'i përmbushur obligimet e veta ndaj *poseduesve të të drejtave*.
3. Gjatë zbatimit të projekteve me të cilat aplikohet QBDNJ, detyrimisht respektohen parimet e të drejtave të njeriut.

⁵⁷ OECD/DAC, Proposed Harmonized Terminology.
Available at: www.undp.org/execbrd/word/Final%20RBM%20terminology%2030%20May.doc.

Hapi 4: Monitorimi dhe vlerësimi

Është ky hapi kur bëhet vlerësimi nëse projekti i zbatuar ka patur ndikim pozitiv në zgjidhjen e problemit të cilin ka patur për qëllim ta zgjidhte.

Monitorimi dhe vlerësimi janë elementet thelbësore të çdo projekti. Në bazë të tyre, kryhet raportimi i qartë dhe i saktë mbi rezultatet e arritura. Veç kësaj, ata japin mundësi për analizë kritike të punës, mësuarje organizative dhe vendimsjellje të informuar.

Monitorimi dhe vlerësimi përfshijnë vëzhgimin dhe notimin e rezultateve reale të projektit, të krahasuara me ato që janë planifikuar ose që janë pritur.

Monitorimi paraqet mbledhje, analizë dhe shfrytëzim të organizuar dhe të vazhdueshëm të të dhënave, për arsye të vëzhgimit të progresit të projektit, konform planit të projektit⁵⁸.

Vlerësimi është një notim periodik i efikasitetit, efektshmërisë, ndikimit, qëndrueshmërisë dhe relevancës së një projekti të caktuar në kontekstin e qëllimeve që i janë dhënë. Zakonisht zbatohet si një notim i pavarur, që ka për qëllim identifikimin e gjetjeve, mbi të cilat do të pushojnë vendimet e ardhshme⁵⁹. Vlerësimi përdoret për matjen dhe vlerësimin e ndikimit afatgjatë të projektit.

Dallimi vendimtar midis monitorimit të projekteve me apo pa QBDNJ qëndron në faktin që në projektet me QBDNJ, përveç matjes së produkteve, rezultatit dhe ndikimit, **detyrimisht maten edhe proceset.**

Monitorimi i projekteve që integrojnë QBDNJ fokusohet në vëzhgimin e realizimit të të drejtave të njeriut, që janë adresuar me projektin. Sipas kësaj, monitorimi dhe vlerësimi fokusohen në tre çështjet e mëposhtme:

- Pjesëmarrja dhe fuqizimi i poseduesve të të drejtave
- Përgjegjësia e bartësve të detyrave dhe
- Ndryshimet në të gjitha nivelet e shoqërisë.

Kjo matje zbatohet përmes llojeve specifike të treguesve, të cilët mundësojnë matjen e progresit dhe vlerësimin e ndryshimeve të jetëve të njerëzve (përfshirë këtu edhe poseduesit e të drejtave dhe bartësit e detyrave). Treguesit që përdoren në projekte që integrojnë QBDNJ masin **rezultatet e arritura, si dhe procesin** brenda të të cilit janë arritur rezultatet.

Përzgjedhja e treguesve duhet të niset nga parimet dhe standardet e të drejtave të njeriut. Nevojiten edhe tregues cilësor dhe sasior, që do ta masin realizimin e të drejtave të njeriut me anë të projektit. Përzgjedhja e treguesve dhe monitorimi duhet qenë participative dhe duhet mundësuar inkuadrimin e palëve të interesuara në vlerësimin e progresit.

Treguesit duhet të përzgjidhen për ta vlerësuar shkallën deri në të cilën të drejtat e njeriut janë inkorporuar në të gjitha fazat e programit, si dhe të ofrojnë pasqyrimin e asaj se si inkorporimi i të drejtave kishte kontribuar për efikasitetin e përgjithshëm të projektit.

58 UNICEF Finland. Introduction to the Human Rights Based Approach – A Guide for Finish NGOs and their Partners. 2015. P.30

59 European Commission, Project Cycle Management Guidelines p. 142. Available at: https://ec.europa.eu/europeaid/sites/devco/files/methodology-aid-delivery-methods-project-cycle-management-200403_en_2.pdf

Lista e kontrollit – A aplikon projekti i caktuar qasjen e bazuar në të drejtat e njeriut?

Kjo listë e kontrollit⁶⁰ (Check list) ngërthen në vete analizat kryesore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në çdo hap të ciklit të projektit. Mjetet dhe analizat tjera që i përkasin ciklit të projektit mbeten të pandryshuara.

Lista e kontrollit ofron mundësinë e vetëvlerësimit për çdo projekt të zbatuar, sa ai respekton parimet e qasjes së bazuar në të drejtat e njeriut? Vetëvlerësimi zbatohet me dhënien e përgjigjes në pyetjet e numëruara më poshtë. Në rastin ideal, për të konsideruar se një projekt i caktuar përmbush kërkesat e qasjes së bazuar në të drejta, nevojitet përgjigja e të gjitha pyetjeve të jetë **Po**.

Kjo listë mund të përdoret gjatë përgatitjes dhe planifikimit të projekteve. Në qoftë se përgjigja në disa nga pyetjet është **Jo**, atëherë duhet përsëritur analiza të caktuara dhe duhet bërë korrigjimet përkatëse.

	Po	Jo
Hapi 1: Analiza e gjendjes		
1. A është identifikuar qartë problemi që duhet të adresohet, së bashku me shkaqet e ekzistimit të tij (duke përfshirë këtu shkaqet e menjëhershme dhe ato elementare)?		
2. A është kushtuar vëmendje e mjaftueshme në analizimin e raporteve të fuqisë, diskriminimit, jobarazisë, përkatësisë etnike, gjinisë, etj.?		
3. A janë identifikuar subjektet që do të hyjnë në rolet e poseduesve të të drejtave dhe bartësve të detyrave?		
4. A janë identifikuar raportet më të rëndësishme që prekin të drejtat e njeriut në mesin e poseduesve të të drejtave dhe bartësve të detyrave? A janë identifikuar të drejtat e njeriut që nuk janë realizuar? A janë identifikuar kërkesat të cilat poseduesit e të drejtave mund t'i kumtojnë (përballë bartësve të detyrave) si dhe obligimet përkatëse të bartësve të detyrave?		
5. A është kryer analiza nëse të drejtat e prekura të njeriut janë të mbrojtura me Kushtetutën e RM, ligjet e brendshme si dhe me marrëveshjet ndërkombëtare të cilat RM ka ratifikuar?		
6. A janë identifikuar: 1. Mungesat më të rëndësishme të kapaciteteve të poseduesve të të drejtave të cilat i pengojnë nga e drejta e kërkimit të realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave të veta, dhe 2. Mungesat më të rëndësishme të kapaciteteve të bartësve të detyrave për t'i përmbushur obligimet e veta ndaj poseduesve të të drejtave?		
Hapi 2: Disenjimi dhe planifikimi i projektit		
7. A janë identifikuar dhe inkuadruar palët kryesore të interesuara (poseduesit e të drejtave dhe bartësit e detyrave) në planifikimin e projektit?		
8. A janë identifikuar gjetje dhe rekomandime për problemin e identifikuar në Hapin 1 nga organet e OKB, Këshillin e Evropës, Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Bashkimit Evropian, si dhe nga organizatat tjera relevante ndërkombëtare dhe kombëtare?		
9. A është përcaktuar se cilat intervenca/aktivitete nevojiten për të fuqizuar kapacitetet e poseduesve të të drejtave që të jenë në mundësi të kërkojnë realizimin e të drejtave të veta?		
10. A është përcaktuar se cilat intervenca/aktivitete nevojiten për të fuqizuar kapacitetet e bartësve të detyrave, që të jenë në mundësi t'i përmbushin obligimet e veta?		

60 Shihni Gruskin S, Tarantola D. "What Does Bringing Human Rights into Public Health Work Actually Mean in Practice?" in International Encyclopedia of Public Health eds. Kris Heggenhougen and Stella Quah. Academic Press, vol. 3, 2008. fq. 137-146.

Hapi 3: Zbatimi i projektit

11. A është strategjia/aktivitetet e planifikuara në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe rekomandimet e organeve ndërkombëtare?

12. A është bërë identifikimi se cilët posedues të të drejtave dhe posedues të detyrave do të përfshihen me procesin e zbatimit të projektit?

13. A është bërë kujdes kur është marrë parasysh detyra për respektimin e të gjitha parimeve të të drejtave të njeriut (Shihni Kapitullin X) në çdo hap të zbatimit të projektit? (cilësia e procesit)

14. A janë identifikuar detyrimet konkrete të cilat bartësit e detyrave duhet t'i marrin me qëllim respektimi, mbrojtja dhe realizimi i të drejtave të poseduesve të të drejtave?

15. A do të kontribuojë zbatimi i projektit për fuqizimin e kapaciteteve të poseduesve të të drejtave në kërkimin e realizimit të të drejtave të tyre (p.sh. të kërkojë ndryshimin e politikës, aksesin në informacion ose aksesin në drejtësi)?

Hapi 4: Monitorimi dhe vlerësimi i projektit

16. A është parashikuar matja e mallrave, shërbimeve dhe produkteve të krijuara me qëllim fuqizimi i kapaciteteve të poseduesve të të drejtave dhe bartësve të detyrave? (Treguesi në nivel të produktit)

17. A është parashikuar matja e ndryshimeve në drejtësi, politika, institucione dhe sjellje që çojnë drejtë kapacitetit të fuqizuar të poseduesve të të drejtave për të kërkuar realizimin e të drejtave të veta nga bartësit e detyrave? (Treguesi në nivel të rezultatit)

18. A është parashikuar matja e ndryshimeve të qëndrueshme dhe pozitive në jetën, dinjitetin dhe mirëqenien e poseduesve të të drejtave (si persona dhe grupe)? (Treguesi në nivel të ndikimit)

19. A është parashikuar matja e mënyrave me të cilat projekti/programi respekton parimet e të drejtave të njeriut, duke përfshirë këtu dhe pjesëmarrjen, inkluzionin dhe transparencën, sidomos për grupet e cenueshme? (Treguesi i procesit)

Bibliografia

- A HUMAN RIGHTS BASED APPROACH TO DENMARK'S DEVELOPMENT COOPERATION – GUIDANCE AND INSPIRATION FOR POLICY DIALOGUE AND PROGRAMMING
- A RIGHTS-BASED APPROACH, ENCOMPASSING ALL HUMAN RIGHTS FOR EU DEVELOPMENT COOPERATION
- APPLYING A HUMAN RIGHTS-BASED APPROACH TO DEVELOPMENT COOPERATION AND PROGRAMMING
- APPLYING A RIGHTS-BASED APPROACH AN INSPIRATIONAL GUIDE FOR CIVIL SOCIETY
- COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT TOOL-BOX A RIGHTS-BASED APPROACH, ENCOMPASSING ALL HUMAN RIGHTS FOR EU DEVELOPMENT COOPERATION
- EVALUATION STUDY LESSONS LEARNED ON THE DANISH HUMAN RIGHTS-BASED APPROACH
- HUMAN RIGHTS MANUAL GUIDELINES FOR IMPLEMENTING A HUMAN RIGHTS BASED APPROACH IN ADC
- INTRODUCTION TO THE HUMAN RIGHTS BASED APPROACH A GUIDE FOR FINNISH NGOS AND THEIR PARTNERS
- SDC'S HUMAN RIGHTS POLICY: TOWARDS A LIFE IN DIGNITY REALISING RIGHTS FOR POOR PEOPLE

